

# 1. HYRJE NË EKONOMI

**Ekonomia** - Ky term rrjedh nga Greqishtja e vjetër nga fjala **οἶκος [oikos]**, dhe do të thotë "shtëpi, tempull, kamp, hallë" dhe fjala **νόμος [nomos]**, që don të thotë *zakon, rregull, konventë që fjalë për fjalë don të thotë "rregull shtëpiak."*

**Ekonomia** është një shkencë shoqërore që merret me studimin e prodhimit, shpërndarjes dhe konsumit të të mirave dhe shërbimeve.


Ndryshe, ekonomia njihet si shkencë e cila studion të gjitha marrëdhëniet që zhvillohen gjatë një procesi ekonomik, qofshin ato mes qenieve njerëzore, qenieve njerëzore dhe mjeteve të prodhimit apo qenieve njerëzore dhe politikave të prodhimit.

## Ndarja sipas përfshirshmërisë

- **Mikroekonomia** është degë e ekonomisë e cila studion njësitë e veçanta të ekonomisë siç janë [familjet](#) apo [ndërmarrjet](#). Kjo degë merret me pjesë të veçanta të [kërkesës](#) dhe [ofertës](#), si dhe me ndërthurjen e tyre.
- **Makroekonomia** është ajo pjese e shkencave ekonomike që merret me studimin e funksionimit të ekonomisë në kuptim të gjërë të fjalës. Në këtë kontekst, ajo analizon format më sintetike të treguesve ekonomikë si: [Prodhimi i Brendshëm Bruto \(PBB\)](#) dhe [ciklet ekonomike](#) të tij, [papunësinë](#) dhe [inflacionin](#), [konsumin](#), [investimet](#), [politikat fiskale](#) dhe [monetare](#), [tregëtinë ndërkombëtare](#), [bilancin e pagesave](#), etj
- Ekonomia shumëdegëshe:
  - **Bujqësore**
  - **Industriale**
  - **Kominikacioni**
  - **Tregtia**
  - **Ndërtimtaria**
  - **turizmi**

## Sipas përfshirjes territoriale

- Ekonomia mund të jetë:
  - A) Lokale
  - B) Regjionale
  - C) Nacionale
  - D) Botërore



- a] Lokale do të thotë e një qyteti si per shembull:Ekonomia e Malisheves,Rahovecit, Klinës etj.
- b] Regjionale do të thotë e një zone P.SH:Prizreni,Prishtina,Peja etj.
- c] Nacionale do të thotë e një shteti siq është ekonomia e Kosovës, e Shqipërisë, etj.
- d] Botërore do të thotë e gjithë botës

Sipas zhvillimit ekonomik shtetet ndahen në:

1. Te zhvilluara,
2. Te pa zhviluara

**Kriteri kryesorë të zhvillimit ekonomikë janë të ardhurat prej kombeve,të ardhurat vjetore, dhe për kokë banori të shprehura në dollarë**


## 1.1.NJË VËSHTRIM I PËRGGJITHSHËM MBI SHKENCËN EKONOMIKE

### I.Ç'është ekonomiksi

Jeta shoqërore është komplekse.Kompleksiteti të saj i përgjigjet kompleksiteti i shkencave shoqërore,çdo njera prej te cilave studion anë të veqanta të jetës shoqërore,të sjelljes së individëve,grupeve shoqërore dhe institucioneve shoqërore.

Ekonomiksi studion pikërisht anën ekonomike të jetës shoqrore,sjelljen e agjentëve ekonomik në shoqëri dhe kushtet ekonomike të bashkëveprimit të tyre .Në rolin e agjentëve ekonomikë ose vendimmarrësve,sikur se quhen ndryshe,paraqiten individët (ose familjet),firmat dhe qeveria.

- **Individet ose familjet** paraqiten si agjentë ekonomikë para së gjithash në rolin e tyre si zotërues burimesh dhe si konsumatorë.
- **Firmë** quhet çdo organizatë që prodhon mallra ose shërbime.
- **Qeveria (shteti)** ghithashtu përfaqëson një agjent ekonomik,pra një vendimmarrës në fushen ekonomike,në rolin e saj si krijuese dhe mbikqyrëse e rregullave të lojës ekonomike,në rolin e saj si prodhuese drejtpërdrejtë mallrash dhe shërbimesh (në masën që është pronare e burimeve prodhuese) si dhe në te gjitha funksionet e tjera ekonomike,që i realizon përmes politikave të saj ndërhyrëse në ekonomi.



Agjentët ekonomikë veprojnë në një mjedis të caktuar ekonomik. Ata hyjnë domosdoshmërisht në marrëdhënje me njëri-tjetrin lidhur me përdorimin e burimeve, lidhur me prodhimin, këmbimin, shpërndarjen dhe konsumin e produkteve të prodhuara. Mjedi ekonomik pëcaktohet, para së gjithash, nga tërësia ose sistemi i këtyre marrëdhënieve, i këtyre lidhjeve. Pikërisht sistemi i lidhjeve ekonomike është objekt studimi i Ekonomiksit.

Në studimin e lidhjeve ekonomike, Ekonomiksi operon me një varg konceptesh bazë që shprehin pikërisht një kryesore të këtyre lidhjeve.

Në zemër të ekonomiksit qëndrojnë konceptet **pasuri** dhe **mirëqënie**.


-**Pasuria** e një vendi në thelb përbëhet nga stoku i tij i mallrave dhe shërbimeve.

-Ndërsa **mirëqënia** i referohet kënaqësisë që një individ apo shoqëria nxjerrin nga konsumi i pasurisë.

### **Koncepti i mirëqënies lidhet me konceptet efiçencë dhe drejtësi**


-**Efiçenca** ka të bëjë me nxjerrjen e një dobie ose kënaqësie maksimale të mundshme nga përdorimi i burimeve ekonomike.

-**Drejtësia** lidhet me shpërndarjen e drejt të mallrave dhe shërbimeve midis grupeve të ndryshme shoqërore dhe individëve.



Nevojat e individëve dhe grupeve shoqërore janë të shumëllojshme. Ato lidhen me karakterin e dyfishtë të qënies njerëzore, si qenie biologjike dhe qenie shoqërore. Nevojave bazë për ushqim, vesh-mbathje, strehim dhe ngrohje u shtohen edhe një varg nevojash të tjera fizike dhe shpirtërore. Rrethi i tyre sa vjen dhe zgjerohet. Edhe për një moment të dhënë kohe nevojat për çdo individ, qoftë ky edhe shumë i pasur, mund të konsiderohen praktikisht të pakufizuar.

Ndërkaqë, sasia dhe llojshmëria e mallrave dhe shërbimeve janë të kufizuara, ky kufizim vjen nga dy faktorë kryesorë: **sasia e burimeve ekonomike në dispozicion** dhe **gjendja e teknologjisë**.



Burimet ose faktorët e prodhimit sikur se quhen ndryshe,zakonisht i klasifikojmë në tre grupe kryesore:

**Puna**- që përfshin aftësinë mendore dhe fizike të njerzëve për të punuarë.

**Toka**-që përfshin pasuritë natyrore të të gjitha llojeve siç janë: toka bujqësore,toka si truall ndërtimi,burimet e energjisë,burimet minerale dhe i gjithë mjedisi fizikë që na rrethon.

**Kapitali**-që përbëhet nga mallrave të prodhuara me qëllim për të prodhuar mallra të tjerë.Me kapital, nga pikëpamja ekonomike kuptojmë vetëm kapitalin fizik,jo kapitalin financiar.

**Elementët kryesore te kapitalit janë** :Paisjet dhe makineritë,ndërtesat,invertari(produkti i gatshëm,prodhimi në proces,lënda e pare).Jo rrallë në klasifikimin që ju bëhet faktoreve të prodhimit veçohet një grup i katërt,që lidhet me aftësinë sipërmarrëse.

**Aftësia sipërmarrëse** i referohet talentit të veçantë që kan disa njerëz për organizimin e burimeve te tjera ekonomike,si puna,toka dhe kapitali ne procesin e prodhimit e prodhimit të mallrave dhe shërbimeve,për kërkimin e mundësive të reja për biznes si dhe për zhvillimin e metodave të reja të prodhimit.Sipërmarrësi i talentuar organizon prodhimin,merr vendime,përballon riskun,bën inovacione.

Faktorët e prodhimit lidhen në procesin e prodhimit sipas parimeve të caktuara teknologjike.


**Teknologjia** i referohet tërsisë së aftësive dhe njohurive shkencore që lidhen me përdorimin e inputeve (faktorëve të prodhimit) në procesin e prodhimit.Niveli i teknologjisë vjen në rritje nga koha në kohë.Teknologjia e avancuar rrit produktivitetin, dmth: sasin e prodhimit për njësi të një inputi.(Shpesh faktorëve të prodhimit do t'ureferohemi si inpute të procesit te prodhimit).

Sasia e burimeve,pra e faktorëve të prodhimit për një ekonomi,në një kohë të dhënë është e dhënë,e kufizuar,ashtu sikurse është i dhënë edhe niveli i teknologjisë.Këtëj buron edhe kufizueshmëria e mallrave dhe e shërbimëve **për shkak të rrallësisë,pamjaftueshmëris** së burimeve.

Ligji i rrallësisë shpall se mallrat dhe sherbimet janë të rrallë,të pa mjaftushëm,sepse të pa mjaftueshëm janë edhe burimet për prodhimin e tyre sipas nevojave të njerëzve për konsum.

Me ligjin e rrallësisë lidhet domosdoshmëria e **zgjedhjes** midis mallrave dhe shërbimeve që duhen prodhuar.Pra,zgjedhja është pasoj e mallrave dhe shërbimeve që duhen prodhuar.Pra ,zgjedhja është pasojë e rrallësisë.Për shkak të rrallësisë së burimeve gjithmonë na duhet të zgjedhim midis përdorimeve alternativave të tyre.

Problemi i alokimit (shpërndarjesë) së burimeve të kufizuara midis nevojave konkruese e faktikisht të pa kufizuara të shoqërisë,bërbën **problemin ekonomik kryesor** të çdo shoqërie, ka disa dimensione.Ai lidhet me tri pyetje kryesore:



- çfarë të prodhohet(dhe në çfarë sasi)?
- si të prodhohet?
- për kë të prodhohet

## 1.2. Pamje e përgjithshme e ekonomisë së tregut

Problemi ekonomik themelor është i njëjtë për të gjitha shoqëritë,ndërsa mënyrat e zgjidhjes së tij janë të ndryshme në shoqëri të ndryshme ,në sisteme të ndryshme ekonomike.

**Mekanizmi i tregut-** përfaqëson një metodë të alokimit të burimeve,pra të prodhimit dhe shpërndarjes së tyre,duke u bazuar në zgjedhjet individuale të kordinuara përmesë tregut.

Në këtë sistem ekonomie janë pikërisht sinjalet e tregut ato që pëcaktojnë alokimin e burimeve.Në pamje të parë, tregu përfaqëson një vend ku blihen dhe shiten mallrat.Ndërsa në një kuptim të gjerë,ekonomik,tregu përfaqëson një marrëveshje bashkëveprimi midis blerësve dhe shitësve të një malli për përcaktimin e çmimit dhe sasisë së tregtuar të tij.

Një element esencial i tregut është *paraja,e cila shërben para së gjithash si mjet këmbimi (blerje) dhe si masë e vlerës,domethënë si mjet për llogaritjen e çmimit të një malli.*


Në një ekonomi tregu çmimet luajnë një rol kryesor.Para së gjithash ato janë bartëse informacioni për agjentët ekonomikë,pëçuese të sinjaleve të tregut të individët,firmat apo qeveria.

Ekonomia e tregut nënkupton pavarësinë e agjentëve ekonomike,aftësinë e tyre për në mënyrë të pavarur mbi veprimtarinë e tyre ekonomike,pra sipermarrjen e lire.Sipermarrja e lire,nga ana e saj,nënkupton pronen private mbi faktorët e prodhimit.Prona private është një tipar esencia i ekonomisë së tregut.

- Le të shohim shkurtimisht se si zgjidhet problemi ekonomik themelor në kushtet e ekonomisë së tregut,pra si u pëgjigjet mekanizmi i tregut pyetjeve çfarë të prodhohet,si të prodhohet dhe për kë të prodhohet.

-Çështja ÇFARË të prodhohet zgjidhet në tregun e produkteve,nëpërmjet “votimit “ të përditshëm të konsumatorëve.

-Çështja si të prodhohet zgjidhet nga konkurenca midis prodhuesve.Mënyra më e mire që prodhuesit të përballojnë konkurrencën e tregut e të maksimizojnë fitimet është minimizimi i kostove,duke përdorur metodat më efikente në prodhim.



-Çështja PËR KË të prodhohet zgjidhet në tregjet e faktorëve.Në këto tregje,pra në tregun e punës,të kapitalit dhe të tokës përcaktohen çmimet e faktorëve dhe sasia e tregtuar e tyre.

- Qeveria ndërhyt në jetën ekonomike duke ndjekur kryesisht tri synime kryesore:
- -Rritjen e efijencës,duke kufizuar format e konkurencës jo të plotë.
- -Sigurimin e drejtësisë në shpërndarje,duke u ardhur në ndihmë të varfërve dhe grupeve të caktuara shoqërore.
- -Stabilizimin e ekonomisë,duke zbutur luhatjet ciklike të ekonomisë,duke reduktuar papunësinë dhe inflacionin dhe duke nxitur rritjen ekonomike.

Pra,ekonomit e sotme të tregut nuk mund të kuptohen pa një rol të konsiderushëm të qeverisë në alokimin e burimeve.Është kjo arsyeja që shpeshë ato konsiderohen si ekonomi të përziera. Sidoqoftë,duhet theksuar se ekonomia e perzierë është në fund të fundit,një ekonomi e tregut,e bazuar ne mekanizmin e tregut dhe në pronën private mbi faktorët e prodhimit.

### 1.3. Pse të studiohet ekonomia?


Ekzistojnë shkaqe të panumërta dhe të nduarduarshme pse individët,ose grupet e caktuara shoqërore,interesohen për t'i kuptuarë më mirë si dhe për t'i shpjeguar problemet e tyre të përditshme ekonomike.Përgjigja është shumë e thjeshtë dhe ka të bëjë me atë se emri ekonomi më së shpeshti nderlidhet me sfidën dhe problemin e ekzistencës së individit.

Në jetën e përditshme,individët dhe grupet e caktuara shoqërore kanë kërkesa,por edhe,interesa të shumta ekonomike.Pse individët jetësisht janë të interesuar për të studiuarë dhe kuptuarë këtë discipline shkencore?

Arsyeja parësore qëndron në faktin se në kushtet e kalimit nga ekonomia e planifikuar (centraliste) në ekonominë e tregut,individët patjetër duhet të pajisen me njohuri thelbësore ekonomike,si p.sh si të bëj zgjedhjen,si të marrin vendimet,si t'i kuptojnë fshehtësirat e veprimt të tregut,pse pagat dhe standarti jetësor janë në nivel të ulët ose pse disa individë ose disa shtete,bëhen shumë të pasur,e disa të tjerë vdesin nga uria etj.?

Rëndësia,thënë më saktësisht domosdoshmëria e njohjes dhe studimit të lëndës së ekonomisë(pasi që individët hulumtojnë dhe merren vetëm me ato gjëra dhe fenomene për të cilat kanë interes,rëndësi për të),konsiston në disa fakte themelore:

Fakti i parë, konsiston në atë se të gjitha resurset në natyrë janë të rralla,të limituara(kufizuara) dhe se çdo individ në shoqëri,qoftë ai konsumator apo prodhues dëshiron që vetes t'i siguroj një jetë sa më cilësore dhe një super standart jetësor.



Për realizimin e këtij qëllimi parësor si pengesë më së shpeshti paraqitet fakti se resurset janë të limituara, ky super standart mund të arrihet vetëm në dëm të ndonjë individi, ose resursi tjetër.

#### **1.4. Pse të mësohet ekonomia?**

Njohja dhe të kuptuarit e fenomeneve, ligjeve dhe kategorive më parësore ekonomike, individëve ua mundëson por në anën tjetër dhe ua lehtëson:

-Njohjen me mënyrën e re dhe më bashkëkohore të të menduarit shoqërorë, politik, ekonomik dhe social;

-Njohjen më të mirë dhe më të lehtë me mënyrën se si funksionon ekonomia dhe shoqëria në periudha të ndryshme kohore;


-Njohjen me ekonominë si mjet për analiza të ndryshme;

-Hulumtimin se si një firmë apo kompani, në mënyrë sa më efektive mund t'i realizojë qëllimet dhe aspiratat e saja afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjate;

-Nëse i kuptoni problemet dhe fenomenet më parësore ekonomike dhe nëse keni rast të prisni në radhë për të kërkuar punë, do t'i dini dhe kuptoni, shkaqet të pritjes suaj.

## **2. KËRKESA DHE OFERTA**

Fakti që jetojmë në një botë në të cilën burimet janë të kufizuara, të pa mjaftueshme, na detyron që midis alternativave të mundshme të arrijmë qëllimet tona individuale. Përderisa individët nuk mund të plotësojnë nevojat me produktet e prodhuara prej tyre, ata janë të detyruar të dalin në treg, si blerës apo si shitës. Çdo pjesëmarrës në treg kërkon të fitojë nga këmbimi. Natyrisht, blerësit duan çmimin më të ulët të mundshëm, kurse shitësit çmimin më të lartë. Ballafaqimi në treg i shitësve dhe blerësve përcakton çmimin e tregut dhe sasinë e tregtuar, pra dhe të prodhuar për çdo produkt.



## 2.1. Kërkesa


Për një ekonomist, kërkesa përfaqëson sasi të një produkti, që blerësit janë njëkohësisht të gatshëm dhe në gjendje të blejnë me çmime të ndryshme të mundshme gjatë një periudhe kohe të dhënë (ditë, javë, muaj, etj), kur gjithë kushtet e tjera merren të pandryshuara.

Meqenëse ekonomistët janë të interesuar për faktin se si ndryshon sasia e blerë me ndryshimin e çmimit, ata e përcaktojnë kërkesën si një lidhje midis çmimit dhe sasisë. Ndërsa termi sasi e kërkuar përfaqëson sasinë që konsumatorët do të blejnë me një çmim të caktuar gjatë një periudhe kohe të dhënë.

Konsumatorët blejnë produkte për të plotësuar nevojat e caktuara të tyre. Por nevojat nuk është njëjtë me kërkesën. Që një blerës të ketë kërkesë për një produkt, nuk është e mjaftueshme të ketë nevojë për të, ai duhet që një kohësisht të jetë i gatshëm dhe në gjendje të blejë këtë produkt.

Lidhja midis sasisë së kërkuar dhe çmimit shprehet nga ligji i kërkesës, sipas të cilit, kur çmimet e produkteve ulen, sasia që blerësit janë të gatshëm dhe në gjendje të blejnë rritet dhe kur çmimet rriten, sasia e kërkuarë pakësohet, me kusht që faktorët e tjerë të mbetën të pandryshuar. Pra, ekziston një lidhje e zhdrejtë midis çmimit sasisë që konsumatori dëshiron të blejë.

Situta	Nivelet e kërkesës për grurë	
	(1) Çmimi (00/L/kv)	(2) Sasia e kërkuar (000/kv/muaj)
A	5	9
B	4	10
C	3	12
D	2	15





E	1	20
---	---	----

Tabela 2.1:Kërkesa për grurë

I analizojmë me radhë keta faktor dhe ndikimin e tyre te kerkesa.

### **Te ardhurat e konsumatoreve:**

Meqenëse konsumatorët duhet të jen në gjendje të paguajn për të patur kërkes për një produkt,është e kuptueshme që të ardhurat janë një faktor përcaktues i kërkesës.Zakonisht,një rritje e të ardhurave bën,megjithëse jo gjithmon që konsumatorët të blejn më shumë produkte.

### **Çmimet e mallrave zëvendësues dhe plotësues:**

Për të qen racional në zgjedhjet e tyre ,konsumatorët mbajnë parasysh faktin se disa të mira janë te lidhura me të tjerat.Psh.gruri dhe misri janë **zëvendësues** të njëri –tjetrit ,dmth.ato mund të përdoren në vend të njëri-tjetrit për të plotsuar një nevoj të konsumatorit.Ndërsa automjeti dhe karburanti janë plotësues te njëri-tjetrit.Ato përdoren së bashku dhe në qoftë se konsumatori blen njërin prej tyre,ai duhet të blej edhe mallin tjetër.

### **Pritjet e konsumatorëve:**


Konsumatorët ndikohen edhe nga pritjet,dmth,parashikimet e tyre për të ardhmen ,sidomos nga ndryshimet që priten në të ardhurat e tyre dhe në çmimet e mallrave që konsumojnë.

Psh,njerzit priren të rritin shpenzimet e tyre aktuale kur presin një të ardhur më të lartë në të ardhmen e afërt.Në këtë mënyrë, parashikimi për një rritje të të ardhurave në të ardhmen dhe rritja aktuale e të ardhurave(e analizuar më sipër),kanë të njëjtin rezultat:ato rrisin kërkesën për të mira normale dhe ulin kërkesën për të mira inferior.

### **Shijet dhe preferencat :**

Për të zgjedhur se cilin produkt do të blejnë, konsumatorët mbajnë parasysh dobin që parashikojnë të nxjerrin nga konsumi i produkteve të ndryshme.Vlerësimi që një person i bën vajtjes në stadium për të parë një ndeshje sportive(pra çmimi që ai është i gatshëm të paguaj për biletën),do të varet nga preferencat e tij për sportin.

Ne qoftë se ky person pëlqen më shumë futbollin ndaj basketbollit,ai do të jetë i gatshëm të themi të paguaj 50 lekë për të ndjekur një ndeshje futbollit në stadium,por vetëm 10 lekë për një ndeshje basketbolli.



## 2.2. Oferta

Përfaqëson sasi të një produkti që shitësit janë njëkohësisht të gatshëm dhe në gjendje të ofrojnë për shitje me qmime të ndryshme.

**Ligji i ofertës**, sipas këtij ligji, shitësit do të ofrojnë një sasi më të madhe për shitje kur qmimet rriten, dhe e kundërta.

Si përfundim theksojmë se në qoftë se shitësit ofrojnë më shumë si rezultat i rritjes së çmimit të produktit, themi se kemi një rritje në sasinë e ofruar. Ndërsa në qoftë se shitësit ofrojnë më shumë për çdo çmim të mundshëm themi se kemi një rritje në ofertë.

Ndër faktorët kryesorë që ndikojnë të oferta mund të përmendim: (1) çmimet e faktorëve të prodhimit; (2) teknologjinë e përdorur; (3) çmimet e mallrave të lidhur; (4) pritjet e ofruesve; (5) numrin e ofruesve.

**Çmimet e faktorëve të prodhimit (burimeve)**- Dihet që para se një produkt të ofrohet për shitje, ai duhet të prodhohet duke përdorur burime të caktuara, çmimet e këtyre burimeve ndikojnë të kostoja e produktit dhe për pasojë janë një faktor përcaktues i ofertës. Një rritje në çmimin e burimeve rrit kostot e produkteve dhe në kushtet e çmimit të dhënë në tregun e produktit ul ofertën, dhe e kundërta.

**Teknologjia**- Një përmirësim në teknologji nënkupton që produkti mund të prodhohet në mënyrë më efikente, dmth me një kosto më të ulët. Pra, një përmirësim në teknologji ul koston e produktit dhe çon për rrjedhojë në një rritje të ofertës.

**Çmimet e mallrave të lidhur**- Kur duan të marrin vendim për të ofruar produkte në treg, ashtu sikurse dhe gjithë vendimmarrësit e tjerë, shitësit analizojnë dhe krahasojnë alternativat e mundshme të marrjes së vendimit. Bujqit duhet të zgjedhin se çfarë do të kultivojnë grurë apo ndonjë kulturë tjetër bujqësore. Prodhuarit e televizorëve duhet të zgjedhin nëse do të prodhojnë televizorë me ngjyra apo bardhë e zi etj. Si bujku ashtu edhe prodhuesi i televizorëve mund të prodhojnë nga të dyja alternativat, por kapaciteti prodhues është i kufizuar gjat një periudhe të dhën kohë.

Në qoftë se do të prodhohet më shumë nga njëri prej produkteve psh. televizorë bardhë e zi, do të prodhohet më pak nga produkti alternativ televizorë me ngjyra.

**Pritjet e ofruesve**-Ashtu sikurse blerësit edhe shtësit mbajnë parasysht qka pritjet të ndodhë në të ardhmen për të marrë vendimet e tyre për ofertën e produkteve. Kështu, në qoftë se një prodhues këpucësh pret që kërkesa për këpucë të rritet në të ardhmen, ai do të ulë shitjen aktuale të këpucëve (ose do të rrit rezervat e këpucëve), në mënyrë që të shesë më shumë kur qmimi të jetë më i lartë. Një pritje për rritjen e çmimit të produktit në të ardhmen e rrit koston oportune të shitjes aktuale të produktit në krahasim me shitjen kur qmimet do të jenë më të larta. Një kosto oportune më e lartë ul ofertën. Pra, kur pritjet që çmimet të rriten, oferta aktuale do të synojë të ulët dhe e kundërta.

### **2.3.EKUILIBRIMI I TREGUT(OFERTËS DHE KËRKESËS) NËN VEPRIMIN E ÇMIMEVE**

Oferta dhe kërkesa, këto dy pole të kundërta, për funksionimin normal të tregut si peshore e padukshme, por shumë efektive në afat të shkurtër, mund ta bëjë baraspeshën, por shumë të brishtë, e cila lëkundet dhe e humb drejtpeshimin. Në rastin më të mirë ekonomia qëndron buzë barazpeshës vetëm rastësisht dhe në afat fare të shkurtër mund të ekuilibrohet plotësisht. Arsyeja qëndron në atë se ekonomia e tregut nuk është ekonomi e derigjuar, por plotësisht e lire. Firmat me xhelozë të theksuar i ruajnë sekretet e planeve të tyre, prandaj, kur dalin në treg, konstatojnë realitetin se me qfarë kushte individuale ofrojnë prodhuesit e një dege për ballë sasisë së kërkuar për atë lloj malli. Nëse oferta e tejkalon kërkesën e aftë blerëse, çmimet do të ulen e që ka si pasojë veprimin negativ në ofertë e cila duhet të bie, sepse shitja me çmime të ulëta ua zvogëlonë fitimin.

Nëse oferta është më e ulët se kërkesa e aftë blerëse, çmimet rriten dhe e stimulojnë prodhimin, sepse rritet fitimi, por kjo ngjanë deri në momentin e baraspeshimit kur oferta barazohet me kërkesën e aftë blerëse. Pra ngritja dhe ulja e çmimeve e shkakton rritjen, përkatësisht zvogëlimin e ofertës. Këto lëkundje të ofertës dhe kërkesës si ecje të kundërta nga çmimet, ngadalë por mjaft sigurt e shkaktojnë harmonizimin e tregut.

Ashtu si qmimi që e kushtëzon ofertën, në një anë e kërkesën në anën tjetërë, edhe këto veprojnë në çmime, çdo faktor në mënyrën e vet. Në raste ekstreme, kur me veprime të këtilla ofertat dhe kërkesat nuk mund të harmonizohen, atëherë firmat që s'mund t'u adaptohet kushteve të tregut, janë të detyruara ta riorientojnë prodhimtarinë e tyre në degë tjetërë ekonomike, kuptohet në ato degë ku oferta është më e ulët se kërkesa. Ky veprim, ku kapitali kalon prej dege në degë quhet shtegtim i kapitalit. Në degën prej nga ka shtegtuar ky kapital zvogëlohet oferta, dhe ngriten çmimet, por në degën ku vendoset është veprim i kundërt, atje rritet oferta e ulët çmimet.

Me këto shtegtime, shkuarje dhe ardhje të kapitalit bëhet barazimi i ofertës me kërkesën dhe në përgjithësi e bënë harmonizimin e tregut, por nuk do të thotë se vetëm ky shtegtim është me vendim parësor, sepse firmat në planet e tyre mund të rrisin ose zvogëlojnë prodhimtarinë që e

bënë më të komplikuar precizimin e harmonizimit të tregut, e harmonizim të plotë gati asnjëherë nuk ka.

Çmimet	Oferta	Kërkesa
10	10	100
30	25	80
50	50	50
60	70	35
70	100	10


Për ekonominë niveli i konsumit është i pëcaktuar tërësisht nga niveli i prodhimit: nuk mund të konsumohet më shumë nga se prodhohet.

Por nuk ndodh kështu në ekonominë e hapura, domethënë me ekonominë që hapen ndaj njëra tjetrës lidhur me shkëmbimin e mallrave dhe të shërbimeve. Në këto kushte, një vend mund të konsumojë edhe mallrat e prodhuara në vende të tjera, duke zgjeruar mundësitë e konsumit të mundësive të prodhimit.

## 2.4.ZGJEDHJA KONSUMATORE DHE KËRKESA

Për të kuptuar dhe parashikuar sjelljen e konsumatorit, për të shpjeguar pse njerëzit bëjnë këto apo ato zgjedhje (të cilat rezultojnë në kërkesën individuale për produkte), na ndihmon teoria e zgjedhjes konsumatore.

Çdo subjekt vendimmarrës ekonomik ka përballë pamjaftueshmërinë e burimeve. Kjo vlen edhe për konsumatorin i cili, në marrjen e vendimit se çfarë do të blejë, ndeshet me kufijtë sasiore të parave që ka në dispozicion për të shpenzuar. Ky kufizim monetar individual varet nga e ardhura korrente e tij, kursimet e mëparshme, mundësitë për të marrë hua, e t.j. Për individë të



ndryshëm,kufizimi është i ndryshëm.Në kuadrin e këtij kufizimi,konsumatorët duhet të vendosin sesi të përdorin sa më mirë mundësit e tyre monetare.

Një konsumator racional nuk do të blinte një produkt,në qoftë se përfitimi shtesë që ai parashikon të marrë prej tij është më vogël se shpenzimi shtesë për blerjen tij.Konsumatorët blejnë të mira shërbime për të plotësuar nevojat e tyre.Në çdo rast,përfitimet e marra nga blerjet që ata bëjnë,përfaqësojnë kënaqësitë që sigurohen nga konsumi i mallrave të blera.

Meqenëse mundësitë monetare të konsumatorit janë të kufizuara,ai nuk mund të blejë çdo gjë që i jep kënaqësi,apo ato produkte që i japin kënaqësinë më të madhe.

Përë shembull,konsumatori mund të përfitonte më shumë kënaqësi në qoftë se do të blinte një makinë,në krahasim me një biçikletë por,megjithatë,i detyruar nga mundësit e tij financiare dhe duke ju nështruar parimeve të zgjedhjes racionale,ai kufizohet me blerjen e biçikletës.

Kur vendos të blejë një produkt,në të njëjtën kohë konsumatori ka zgjedhur të mosë blejë diçka tjetër.Domethënë,për çdo zgjedhje që bën konsumatori përballon një kosto oportune.Për shembull,ju mund të zgjidhni të shpenzoni 100 lekë për të blerë një libër ekonomike në vend që të shkoni në një koncert.Në terma ekonomike,kostoja e librit nuk është 100 lekët që ju shpenzuar,por pikërisht kostoja oportune e kësaj blerje,kënaqësia që do të merrnit në qoftë se do shkoni në koncert.

Zgjedhja racionale e konsumatorit mban parasysh balancimin e kënaqësisë shtesë të marrë nga një produkt me kënaqësinë shtesë që mund të merrej nga blerja e një produkti tjetër.Në zbatimin e tij rregull,konsumatorët kërkojnë kombinimin e të mirave dhe shërbimeve që u jep kënaqësinë totale më të madhe,brenda kufizimit të të ardhurave të tyre.

### 3. FIRMAT

---

Për të kuptuar mënyrën e funksionimit të ekonomisë së tregut,është e domosdoshme që të njohim llojet,organizimin e funksionimin e firmave,si dhe objektivat e tyre.

#### **Firmat dhe objektivat e saj**

Firma është një njësi bazë që organizon dhe koordinon faktorë e prodhimit,punën,token kapitalin dhe aftësitë sipërmarrëse,në procesin e prodhimit. Firmat kanë një varg anësh të përbashkëta,ato ndeshen me probleme të tilla si;

- **Çfarë malli apo shërbimi të prodhojnë dhe në çfarë sasi;**
- **Çfarë teknologjie prodhimi të përdorin;**
- **Ç'sasi faktorësh prodhimi të përdorin;**
- **Çfarë structure organizimi dhe drejtimi dhe drejtimi të zgjedhin etj.**

Si objektiv kryesor i një firme konsiderohet **maksimizimi i fitimit**.

### **3.1. Firmat dhe tregjet**

Tregu shërben si mekanizem për të koordinuar planet e shitjes dhe të blerjes së individëve të ndryshëm.

#### **Llojet e firmave**

-Firmat individuale

-Firmat me ortakë

-Korporatat

### **3.2. FIRMA INDIVIDUALE**

Me firm individuale kemi të bëjm atëher kur ajo është pron e një pronari të vetëm dhe drejtohet vetëm prej tij kjo është forma më e thjeshtë e organizimit te firmave .Pronari i firmës është pergjegjës për mbarëvajtjen e firmës dhe për detyrimet që ka ndaj të tjerëve

Si firma individuale mund të përmendim fermat ne bujqësi,dyqanet e shitjes etj.Këto firma janë të vogla ,pajtojnë në punë një numër të kufizur punëtorësh ,pronari merr pjesë në biznes duke kontribuar jo vetëm me kapitalin por edhe me punën e tij.

#### ***Avantazhet e firmës individuale***

Pronari i firmës i merr vetë të gjitha vendimet lidhur me llojin dhe sasinë e produktit ;teknologjinë që do të përdor ;veprimet e financimit , sa pajisje kapitale do të blejë dhe sa punëtorë do të pajtojë në punë, dhe sa par ate tij do të fusë në firmë.Pronari merr vet vetë të gjithë fitimin e firmes.Kjo formë biznesi *organizohet relativisht lehtë* .Ka shum pak kërkesa ligjore lidhur me ngritjen e firmës,rrjedhimisht kostot e organizimi janë të vogla ose të papërfillshme. Lehtësi për t'u future dhe për të dalë nga biznesi. Marrja e vendimeve Brenda nje kohe te shkurte ban te munshme qe keto lloj firmash të jen me fleksibilitet të lart. Qarkullimi I kapitalit realizohet në një kohë të shkurtër dhe fitimi taksohet vetem një her , ne formen e taksës mbi të ardhurat personale.

## ***Disavantazhet***

Është përgjegjësia e pa kufizuar financiare , përgjegjësia e pa kufizuar është përgjyesi ligjore për të gjitha detyrimet e firmës , deri në masën e plotë të të gjith pasurisë së pronarit të firmës në qoftë se firma nuk ka sukses në biznesin që ka zgjedhur dhe për këtë arsye mund të falimentoi, pronari I firmes individuale duhet të shlyejë të gjitha detyrimet financiare që ka ndaj firmave të tjera ose bankës. Në qoftë se nuk i shlyen të gjitha detyrimet atij mund t'i sekuestrohet e gjithë pasuria që zotron . shpesh konsiderohet si disavantazh I firmes individuale edhe kufizimi fizik I jetëgjatësisë së saj nga vetë jetëgjatësia ose vullneti I pranorati të saj.

### **3.3.Firmat me ortak**

Firma më ortakë mund të krijohet me dy ose më shumë pronarë. Secili prej tyre bie dakor që të kontribuojë me një pjesë të punës dhe kapitalit të tij në firmë,të marr një pjesë të fitimit të saj dhe të ketë përgjegjësin e vet në humbjet apo detyrimet e firmës .Si rregull,në këtë formë organizimi numri i ortakëve nuk mund të jetë mbi një limit të caktuar.Një firm më ortakë ka një strukturë organizimi më të komplikuar sa një firmë individuale . Fitimet firmës me ortakë taksohen si të ardhura personale të pronarve .Qdo ortak është ligjërisht përgjegjës për të gjitha detyrimet e firmës ,ortakët kanë përgjegjësi të pa kufizuar madje një ortakë mund të mbajë përgjegjisi edhe për gabimet që mund të bëjnë ortakët e tjer.Firmat me ortakë zakonisht krijohen në profesione të tilla ,si arkitekt,kontabilistdhe jurist

## ***Avantazhet***

Firma me ortakë ashtu si edhe firma individuale mund të krijohet dhe të organizohet lehtësisht. Kjo formë e biznesit është e aftë të terheqë më shumë kapital se sa firmat individuale, në këtë mënyrë shtohen burimet financiare të nevojshme për rritjen dhe zhvillimin e firmes

## ***Disavantazhet***

Disavantazh kryesor edhe për firmën më ortakë është përgjegjësia e pa kufizuar financiare, por ka një veqori në krahasim me firmat e tjera individuale,një ortak mban përgjegjsin edhe për gabimet e ortakve të tjerë Në firmën më ortakë kërkohej pelqimi i të gjithë ortakve për qdo vendim që lidhet me aktivitetin e firmes. Marrëveshjet për të krijuar një firmë më ortak përmban veprime ligjore të nderlikuara për të blerë apo shitur pjesen përkatse në firmë. Qdo ndryshim në përbërjen e ortakve automatikisht qon në shpërberjen e firmës,firmat me ortakë kanë një jetë të kufizuar në biznes. Nëse një ortakë tërhiqet ose vdes marrveshja perfundon në atë moment.

### **3.4.Korporatat**

Korporatat janë një formë e njohur e organizimit të biznesit, megjithëse ato nuk janë shumë si numër në krahasim me dy format e analizuar më sipër. Kapitali i një korporate formohet nëpërmjet shitjes së aksioneve prandaj ato shpesh quhen shoqëri aksionare.

### 3.5. Rrugët e rritjes së kapitalit nga firmat

Firmat individuale dhe firmat me ortakë mund të shtojnë kapitalin e tyre duke marrë hua nga miqtë ose nga banka. Kufizueshmëria e këtyre burimeve kufizon mundësitë e firmës për t'u zgjeruar. Korporata paraqet një avantazh të theksuar në këtë drejtim. Burimet financiare kryesore që mund të sigurojë korporata ndahen në burime financiare të jashtme dhe burime financiare të brendshme. Për të sigurua burime financiare të jashtme korporata përdor këto rrugë kryesore: shitja e obligacioneve; emitimi i aksioneve; marrja e kredive bankare.

#### *Shitja e obligacioneve*

Obligacioni është një letër me vlerë që i sjell mbajtësit e tij të ardhurat të përvitshme, në bazë të përqindjeve fikse të caktuara më parë. Një obligacion përbën një detyrim afatgjatë, 10-15 vjeçar për korporatën. Korporata është e detyruar të paguaj vlerën e obligacionit në kohën e caktuar pavarësisht nëse është me fitim apo jo. Korporata kryen dy lloje pagesash ndaj mbajtësit të obligacionit: a) Pagesën e interesit, e cila bëhet periodikisht çdo vit, gjatë gjithë jetës së obligacionit. b) pagesën e vlerës nominale të obligacionit; në datën e maturimit të borxhit pra kur plotësohet afati i detyrimit.

#### *Emitimi i aksioneve*

Egzistojnë tri lloje aksionesh të zakonshme: aksione të preferuara dhe aksione të konvertueshme. *Aksioni i zakonshëm* i jep të drejtë mbajtësit të tij të jetë bashkëpronar i korporatës të votojë në mbledhjen e përgjithshme dhe të marr pjesë në zgjedhjen e drejtorve. *Aksionet e preferuara* janë të ngjajshme më shumë me obligacionet se sa me aksionet e zakonshme mbajtësit e tyre zakonisht kanë të drejtë të përfitojnë normë interesi fikse dhe nuk mund të kërkojnë rritjen e saj në qoftë se korporata ecën mirë. *Aksionet e konvertueshme* mbajtësit e aksioneve të konvertueshme në dallim nga mbajtësit e aksioneve të dy llojeve të tjera kanë të drejtë për të konvertuar ato në aksione të zakonshme në një datë të specifikuar.

#### *Marrja e kredive bankare*

një rrugë për të rritur kapitalin e vet për korporatën është marrja e huas (marrja e kredis) nga banka ndryshim nga aksionet dhe obligacionet kredia bankare nuk shitet në tregjet financiare. Emitimi i aksioneve shitja e obligacioneve marrja e kredive bankare janë burime që vinë nga jashtë



korporatës dhe luajn një rolë të mdhë në rritjen dhe zhvillimin e saj por ajo ka edhe burimet e mbrenshme të rritjes njëra ndër to është pjesa e fitimit që nuk shpërndahet por i futet në biznes. Janë disa forma me anë të cilave realizohen gllabërimet ose bashkimet e firmave *Bashkimi Vertikal* që ndodh kur bashkohen dy ose më shumë firma të një dege që realizojnë stadi të ndryshme të procesit të prodhimit *Bashkimi Horizontalë* që ndodh kur bashkohen dy ose më shumë firma që prodhojnë të njëjtin produkt ose shërbim ose që realizojnë stadi të ngjashme të procesit të prodhimit

## 4. KOSTOJA

Marrja e vendimit nga ana e një firme për të përcaktuar sasinë e prodhimit apo shërbimit të destinuar për treg, varet nga kostot dhe qmimi i produktit apo shërbimit që ajo prodhon dhe shet.

Në këtë kre hymmë në fushën e analizës ekonomike të firmës, duke e përqendruar vëmendjen në përcaktimin dhe mënyrën e llogaritjes së treguesve të ndryshëm të kostos. Analiza e kostove bëhet, në përshtatje me funksionin e prodhimit, për periudha afatshkurtra dhe periudha afatgjata. Gjithashtu do të japim të plotë konceptin e kostos oportune (ekonomike).

### 4.1. Kostot në periudha afatshkurtra

Duke marrë në konsideratë faktorin kohë në analizën ekonomike, dhamë përcaktimin e periudhës afatshkurtrë, theksojmë se ajo është periudhë e tillë kohore, gjatë së cilës të paktën njëri nga faktorët e prodhimit nuk mund të ndryshojë. Për shembull, faktorë të ndryshueshëm për një periudhë afatshkurtrë mund të jenë: lënet e para, lëndët djegëse, fuqia punëtore, etj. Kurse faktorë të pandryshueshëm mund të jenë kapitali (makineritë, pajisjet, ndërtesat, magazinat) toka etj. Pra, faktorët që përdor një firmë në periudha afatshkurtrë klasifikohen në dy grupe kryesore:

- **Faktorë (inpute) fikse.** Inpute fikse janë ato inpute, madhësia e të cilave nuk ndryshon kur ndryshon madhësia e prodhimit.
- **Faktorë të ndryshueshëm.** Inpute të ndryshueshëm janë ato inpute, madhësia e të cilave ndryshon kur ndryshon madhësia e prodhimit. Në pajtim me këtë klasifikim të inputeve, edhe kostot e tyre klasifikohen në:
- **Kosto fikse (FC).** Kosto fikse janë ato shpenzime monetare që bën firma për inpute fikse të prodhimit, të cilat nuk ndryshojnë kur ndryshon prodhimi i firmës.
- **Kosto të ndryshueshme (variabël, VC).** Kosto të ndryshueshme janë shpenzimet monetare që bën firma për inputet e ndryshueshme të prodhimit, të cilat ndryshojnë në qoftë se ndryshon sasia e prodhimit.

### 4.2. Kostoja oportune

Në përgjithësi, kur bëhet fjalë për koston e një produkti apo shërbimi, vihen në dukje shpenzimet monetare që realizohen për të prodhuar këtë produkt apo shërbim. Për kontabilistët e një

firme, kostoja e një produkti llogaritet me shumën e parave që duhen paguar për të siguruar lëndën e parë, punën, makineritë e paisjet etj.

Kuptimi i kostos nga ekonomistët bazohet në sasinë e burimeve të përdorura dhe mundësitë alternative të përdorimit të tyre. Zgjedhja e burimeve të caktuara për prodhimin e një të mire do të thotë pamundësi e prodhimit të një të mire tjetër. Pra, kostoja oportune (ose ekonomike) e çdo burimi të zgjedhur për të prodhuar një të mirë është e barabartë me vlerën e përdorimit alternativ më të mirë të mundshëm.

Burimet që përdor një firmë për prodhimin e një produkti mund të blihen në treg, mund të merren me qera për procesin përkatës të prodhimit, ose mund të jenë pronë e vetë firmes. Në varësi nga ky fakt, shpenzimet e firmes ndahen në **kosto eksplicite** (të shprehura) dhe **kosto implicite** (të nënkuptuara).

**Kostot eksplicite (te shprehura)** përfaqësojnë shpenzimet monetare që bën firma drejtpërdrejt në treg për blerjen e burimeve, si fuqia punëtore, lëndët e para, energjia elektrike etj.

**Kostot implicite (të nënkuptuara)** lidhen me inputet që janë pronë e vetë firmës dhe janë të barabarta me pagesat monetare që mund të merreshin nga përdorimi më i mirë alternativ i tyre.

Firma, përveç inputeve që blen nga të tjerët, përdor në prqesin e prodhimit edhe inputet e veta (puna e pronarit, kapitali para i investuar prej tij në firmë, ndërtesa që përdor firma dhe është pronë e tij, etj). Nga pikëpamja e firmës shpenzimet që lidhën përdorimin e burimeve të veta janë shpenzime të papaguara ose të nënkuptuara.

**Fitimi normal** është pjesë e kostos ekonomike dhe është e barabartë me koston oportune të burimeve në pronësi të sipërmarrësit (pra me koston e nënkuptuar), domethënë me atë shumë minimale të ardhurash të pronarit, që do ta bënte atë të interesuar për ti mbajtur këto burime në biznesin përkatës.

## 5. Oferta dhe përcaktimi i çmimeve në konkurrencë të plotë

Në një ekonomi tregu çmimet dhe sasia e prodhuar për çdo produkt përcaktohet nga mekanizmi i tregut, nga bashkeveprimi i kërkesës dhe ofertës në treg. Por tregjet e produkteve të ndryshme mund të ndryshojnë nga njeri-tjetri. Në disa tregje egziston një konkurrencë pothuajse e plotë, kurse në disa të tjerë konkurreca është e kufizuar. Ekstremi i kundërt i konkurrencës së plotë është monopoli. Në tregjet me konkurrencë jo të plotë përfshihet edhe konkurrenca

monopolistike dhe oligopoli. Veçoritë e tregjeve në të cilat vepron një firmë është lidhur me sasin e prodhimit dhe çmimet, etj.

### 5.1. Tiparet e tregut konkurrencial

Konkurrenca ka një kuptim të gjerë për shembull, studentët konkurojnë për të fituar vendin e parë në një konkurs, punëtoret konkurrojnë për vende pune, ndërsa firmat konkurrojnë për konsumatorë. Ndërkaq, shprehja konkurrencë e plotë ka kuptim tepër të veçantë. Konkurrenca e plotë karakterizohet nga një sërë veçorish:

1. Ekzistenca një numër të madh firmash në treg. Secila prej tyre tregton vetëm një pjesë të vogël, të pakonsiderueshme të sasisë së përgjithshme që tregtohet.
2. Të gjitha firmat e një degje shesin produkte me karakteristika të njëjta. Produkte homogjene. Për shembull grurë, duhan, etj.
3. Blerësit dhe shitësit janë të mir informuar, kanë njohuri të plota për çmimet dhe produktet në treg.
4. Ekzistenca e lehtësisë së hyrjes dhe daljes së firmave nga degja. Firmat i lëvizin burimet nga një degje në tjetrën pa pengesa ligjore, si patentat, liçencat, etj.

Tipari më i rëndësishëm i konkurrencës së plotë, që buron nga veçoritë e mësipërme, është se firmat janë çmimpranuese, ato nuk kanë asnjë ndikim mbi çmimin e produkteve që ofrojnë në treg. Çmimi përcaktohet nga kërkesa dhe oferta e tregut, dhe firma të veçanta mund të ofrojnë gjithëçka duan me atë çmim. Pra, konkurrenca e plotë mund të përkufizohet si një lloj tregu, në të cilin firmat e veçanta nuk kanë kontroll mbi çmimin e produkteve që shesin.

Duke qenë se çdo firmë që vepron në konkurrencë të plotë zë një pjesë të vogël të tregut, është e qartë që ajo nuk mund të ndikojë mbi çmimin. Firma mund të marrë vendime vetëm lidhur me sasinë. Me çmimin që përcakton tregu, firma mund të shesë çfardo sasive që deshiron. Firma mund të shesë pa pengesa me çmimin e tregut, ajo nuk ka interes të shesë me çmime më të ulta. Po të shiste me çmime më të larta, asaj do t'i ngeleshin produktet pa shitur, pasi ka shumë firma të tjera që shesin të njëjtin produkt me çmimin e tregut.

Ai fermer që nuk arrinë t'i përballojë shpenzimet me çmimin e tregut, është i detyruar të falimentojë.

### 5.2. Vendimet dhe oferta e firmës në një periudhë afatshkurtër

Në kushtet çmimi përcaktohet nga tregu dhe firma mund të shesë çdo lloj sasive me këtë çmim, lind pyetja: cili është niveli i prodhimit që zgjedh firma? Për të kuptuar më mirë përgjigjen e kësaj pyetjeje rikujtojmë që:

- Synimi themelor i çdo firme është maksimizimi i fitimit.
- Fitimi përfaqëson midis të ardhurave totale (TR) me koston totale (TC)
- Për ekonomistët kostoja totale është kosto ekonomike (oportune), pra përfshin koston e shprehur dhe atë të nënkuptuar.

Mbi këtë bazë, përgjigjia e pyetjes do të ishte: firma zgjedh atë nivel prodhimi që maksimizon fitimin e saj.

Të ardhurat marxhinale kuptojmë ndryshimin në të ardhurat totale kur prodhimi ndryshonë me një njësi.

### 5.3. Sjellja e firmës dhe e degës në periudha afatgjata

Për të analizuar dhe kuptuar më mirë sjelljen e firmës dhe të degës wshtë e nevojshme të dallojmë tre periudha kohore të mundshme të ekuilibrit të tregut:

- Ekuilibri momental, ku oferta është fikse.
- Ekuilibri afatshkurtër, ku firmat mund të rrisin prodhimin, megjithëse kapitali mbetet i pandryshuar.
- Ekuilibri afatgjatë, ku të gjithë faktorët e prodhimit mund të ndryshojnë.


**1). Ekuilibri momental**, supuzojmë një rritje të kerkesës për një të mir që priset shpejtë, si qumështi për një periudhë fare të shkurtër, për shembull ditore. Oferta është e dhënw e pandryshuar, sepse prodhimi kërkon një kohë për t'u rritur, prandajë një rritje e kerkesës do të rritë shumë çmimin momental të qumështit. Kjo rritje e madhe e çmimit është e nevojshme për të racionuar ofertën midis konsumatorëve.

**2). Ekuilibri afatshkurtër** – një rast konkret çmimi i lartë mbizotëruese në treg nxit pronarët e deleve të marrin punëtorë të rinj dhe të përdorin më shumë ushqim për delet. Edhe pse ata nuk kanë mundësi që për një kohë të shkurtër të blejnë dhe të fusin dele ekzistuese të rejanë prodhim, ushqimi dhe shërbimi më i mirë ndajë deleve ekzistuese do të jepte një sasi më e madhe qumështi për treg se ajo ekuilibrit momental. Çmimi i ekuilibrit për periudha afatshkurtra është më i ulët se çmimi i ekuilibrit momental.

**3). Ekuilibri afatgjatë** - Në periudha afatëgjata është e mundshme të rritet numri i deleve dhe mundë të permirsohet edhe teknologjia, që do të çonte në një ofertë më të madhe të qumështit.

Pra midis periudhave afatgjata dhe periudhave afatshkurtra ekzistojnë ndryshime, të cilat shfaqen në keto aspekte thelbësore:

- Në periudha afatgjata (LR) nuk ka kosto fikse të gjitha kostot janë të ndryshueshme.
- Duke qenë se në periudha afatgjata firma mundë të ndryshojë madhësinë e impianteve të saj,
- Në periudha afatgjata kemi hyrje të firmave të reja në degë ku firmat ekzistuese marrin fitim ekonomik. Nga ana tjetër, kemi dalje të firmave nga dega në qoftë se ato nuk marrin të paktën fitimin normal, pra pasojnë humbje ekonomike.



## Sqarimi i ketyre shkurtesave

LRMC- është kostoja marxhinale në periudha afatgjate.

LRAC- është kostoja mesatare në periudha afatgjata.

SRMC- është kostoja marxhinale në periudha afatshkurtra.

SRAC- është kostoja mesatare në periudha afatshkurtra.

## 6. Sektori publik

Në një ekonomi tregu, rol vendimtar në zgjidhjen e problemit ekonomik themelor luanë vetë tregu me mekanizmin e tij të çmimeve. Megjithatë, një rol të ndjeshëm në zgjidhjen e këtij problemi lun edhe shteti, organet qeveritare të gjitha niveleve, për më tepër, historia e këtij shekulli e zhvillimet të vendeve të perparuar me ekonomi tregu, dëshmon për një prirje në rritje, megjithëse me zikzake, të rolit të shtetit në të jetën ekonomike. Kjo prirje reflektohet në rritjen e shpenzimeve qeveritare dhe taksave, në rritjen e rolit kontrollues të qeverisë, etj. Përmes

instrumenteve të tilla si taksat, shpenzimet qeveritare, aktiviteti kontrollues e rregullues, qeveria (duke nënkuptuar me qeveri të gjithë strukturat shtetërore) ndikon në zgjidhjen e çështjeve kryesore që lidhen me problemin ekonomik themelor: **çfarë** të prodhohet, **si** të prodhohet dhe **për kë** të prodhohet.

## 6.1. Përse është e nevojshme ndërhyja e shtetit në ekonomi

Shkurt, pyetjes së mësipërme mund t'i përgjigjeshim: shteti duhet të ndërhyjë në ekonomi pikërisht për shkak të “dështimeve” të tregu.

Me “dështime” të tregut do të kuptojmë të gjitha papërsosmeritë e mekanizmit të tregut, që pengojnë arritjen e rezultateve optimale. Kur flasim për rezultate optimale të pritura nga shoqëria, kemi parasysh para së gjithash:

**Së pari**, alokimin optimal të burimeve, pra edhe sigurimin e një strukture optimale të produktit të prodhuar.

**Së dyti**, sigurimin e drejtësisë në shpërndarje.

**Së treti**, përdorimin e plotë të burimeve (punëzënie e plotë) dhe stabilitet çmimesh.

Le të shohim me radhë, në secilin nga drejtimet e mësipërme, papërsosmërit e mundshme të tregut.

### Alokimi (përndarja) optimal i burimeve

Alokimi optimal i burimeve nënkupton arritjen e pikës me të dëshirueshme në kurbën e mundësive të prodhimit. Ekzistenca e papërsosmërive të tregut nënkuptonë që forcat e kërkesës dhe të ofertës nuk çojnë në pikën e ekuilibrit komunitare. Kjo do të thotë se për të arritur në këtë pikë ekuilibri, nevojitet ndërhyrja qeveritare.

Burimet e dështimeve të tregut për një alokim optimal burimesh lidhin me natyrën e mallrave të caktuara dhe strukturën e tregjeve të caktuara. Le të shohim disa prej këtyre burimeve.

### Të mirat publike

Në qoftë se blini një qokollat dhe e konsumoni atë, duke nxjerrë një kënaqësi të caktuar, padyshim që i keni përjashtuar të tjerët nga shijimi i kësaj qokollate. Nga nxjerrja e kënaqësisë prej sajë, nga konsumi i saj. Një e mirë e tillë, konsumi i së cilës nga një person përjashton konsumin e sajë nga personat të tjerë, quhet e mirë private.

### Eksternaliteti

Për të kuptuar eksternalitetet, le t'i hedhim një sy tregut të duhanit blerja e cigareve, pra edhe çmimi i tyre, reflekton këkesën e njerëzve që pijnë duhan për këtë mall, pra edhe kënaqësinë apo dobinë e pritur nga konsumi i duhanit. Por njerëzit e tjerë e tjerë, që nuk e pijnë duhanin dhe që ndoshta nuk duan t'ia ndejnë erën atij, mund të provojnë pakënaqsi, bile edhe dëmtrim të shëndetit nga konsumi i cigareve prej duhanpirësve. Kjo kosto, ky dëmtrim i njerëzve të tjerë, nuk pasqyrohet në treg, domethënë është e jashtme (eksternale) për tregun e cigareve.

### **Fuqia tregtare**

Në të dy rastet e mësipërme, pra të mirave publike dhe eksternaliteteve, tregu “dështonë” në arritjen e kombinimit optimal të prodhimit për shkakë të sinjaleve shtrembëruara që japinë ” në arritjen e kombinimit optimal të prodhimit për shkakë të sinjaleve shtrembëruara që japinë çmimet në treg. Çmimi që konsumatori është i gatshëm dhe në gjendje të paguajë për një të mirë të caktuar, nuk reflekton të gjitha përfitimet dhe kostot e asaj të mire. Por tregu mund të “dështojë” edhe kur sinjalet që japin çmimet në treg janë të sakta.

### **Sigurimi i drejtësisë në shpërndarje**

Të mirat publike, eksternaliteti, fuqia tregtare shkaktojnë mos alokim të burimeve, pra lidhen me pyetjen çfarë të prodhojmë. Në të gjitha ketu raste, sikur e pamë më sipër, kërkohej ndërhyrja qeveritare. Një çështje tjetër që lidhet me problemin themelor është pyetja për kë të prodhohet? Një problem tjetër i nderlikuar çdo ndërhyrje e qeverisë në fushën e shpërndarjes mund të ketë pasoja negative në efikasitet.

### **Përdorimi i plotë i burimeve dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve**

Përsosmëritë e analizuar deri tani si përsosmëri mikroekonomike të tregut, lidhen me alokimin jo optimal të burimeve ose me shpërndarjen jo të drejtë të produkteve të prodhuara. Të dhënat statistikore mbi zhvillimin ekonomik të vendeve me ekonomi tregu provojnë se rritja ekonomike bëhet përmes luhatjeve ciklike dhe se inflacioni jo rrallë është bërë problem shqetësues për këto vende. Papunësia, që reaultonë nga mospërdorimi i plotë i burimeve, dhe inflacioni përbëjnë dy nga “dështimet” kryesore makroekonomike të tregut dhe përballimi i tyre kërkon ndërhyrjen e shtetit me anë të politikave përkatëse.

## **6.2. Sektori publik dhe përmasat e tij**

Arsyet e trajtuar më sipër, që bëjnë të nevojshme ndërhyrjen shtetërore në ekonomi, përcaktojnë edhe funksionet kryesore ekonomike të shtetit. Funksionet kryesore ekonomike të shtetit në një ekonomi moderne tregu mund të përmbliken si më poshtë:

- Krijimi dhe jetësimi i kuadrit të nevojshëm ligjorë për një ekonomi tregu.
- Hartimi dhe zbatimi i politikave stabilizuese makroekonomike.

- Ndërhyrja në alokimin e burimeve për të permisuar efikasitetin ekonomik.
- Hartimi dhe zbatimi i programeve për rishpërndarjen e të ardhurave

Agjentët ekonomik kërkonë përveq veprimit të forcave ekonomike të tregut, edhe vendosjen e një kuadri të përshtatshëm ligjor lidhur me sjelljen e ktyre agjentëve, pikërisht familjeve (individëve), firmave, vetë qeverisë. Në këtë kuadër ligjor, më rëndësi të veçantë janë ligjet dhe rregullat mbi pronën, mbi kontratën dhe sjelljen reciproke të palëve bashkëvepruese, detyrimet cesiproke të punonjësve dhe administratës së firmave.

Rrugët kryesore të ndërhyrjes qeveritare në aktivitetin ekonomik janë:

**Taksimi.** Qeveria vendos taksa për të ndikuar në alokimin e burimeve, për të ndikuar në shpërndarjen e të ardhurave dhe përgjithësisht për të krijuar fondet e nevojshme për shpenzimet qeveritare.

**Shpenzimet publike,** që synojnë në nxitjen e firmave për të prodhuar llojet të caktuara mallrash shërbimesh si dhe kryerjen e pagesave transferuese për mbeshtetjen e shtresave apo grupeve të caktuara të popullsisë. Shpenzimet publike mund të marrin edhe formën e investimeve të drejtpërdrejta shtetërore për prodhimin e mallrave apo shërbimeve të caktuara. Ata lidhen edhe me plotësimin e disa nevojave të përgjithshme shoqërore, si rendi, mbrojtja, etj

**Veprimtaria antitrust,** që synon në nxitjen e strukturave konkurruese të tregut, duke mos lejuar krijimin, në degë të caktuara, të strukturave monopoliste dhe duke pakësuar fuqinë tregtare të firmave.

**Politikat rregulluese,** që synojnë në rregullimin e sjellin së firmave. Duhet dalluar rregullimin ekonomik nga rregullimi social. Rregullimi ekonomik lidhet me çmimet, prodhimin dhe pengesat e hyrjes apo daljes së një firme nga dega. Rregullimi social lidhet me kushtet e punës e detyrimet të tjera sociale të firmave ndj punonjësve apo shoqëris në tërësi. Politikat rregulluese kanë kostot e tyre, siq janë kostot administrative, kostot që përballojnë vetë firmat nga ketu politika, kostot potenciale të cenimit të efikasitetit për shkak të vendimeve të gabuara apo të bazuara në informacion të gabuar, etj.

Ekonomistët, shpesh, duke pranuar papërsosmëritë apo dështimet e tregut, tërhiqin vëmendjen edhe për papërsosmëritë apo “dështimet” e qeverisë, pra të ndërhyrjes qeveritare.

Shpenzimet publike parashikohen në buxhetin qeveritar (përfshirë këtu edhe buxhetin e pushteteve lokale). Në buxhetin, i cilin miratohet nga parlamenti për çdo vit fiskal (fillimi dhe mbarimi i një viti fiskal, mund të nryshojnë nga fillimi dhe mbarimi i një viti kalendarik), parashikohen zëra të tillë shpenzimesh publike si:

⇒ Shpenzime për mallra dhe shërbime, ku përfshihen shpenzimet korrente për shërbimet e mbrojtjes kombëtare, ruajtjes së rendit, arsimit, administratës publike, etj.



- ⇒ Shpenzime për investime publike (shpenzime kapitale), siç janë shpënzimet për rrugët, urat, ndërtimin e spitaleve, shkollave, etj.
- ⇒ Subvencionet ndaj degëve apo ndërmarrjeve të caktuara, publike apo private.
- ⇒ Pagesat transferuese ndaj individëve apo familjeve, ku përfshihen pensionet, përfitimet për papunësinë, pagesat për asistencën sociale, etj.
- ⇒ Pagesat e interesave për huatë publike, etj.

Shpenzimet publike parashikohen dhe realizohen si shpenzime të qeverisë qendrore dhe shpenzime të administrave lokale.

### 6.3. Financimi i sektorit publik


Për financimin e shpenzimeve shtetërore përdorën të ardhurat shtetërore, të cilat, ashtu si shpenzimet, parashikohen në buxhetin e shtetit sipas burimeve të krijimit të tyre. Në vendet e industrializuara perendimore, burimi kryesor të të ardhurave shtetërore e përbëjnë taksat. Taksat përfaqësojnë transferime të detyrueshme monetare nga individët, firmat dhe nga institucionet e ndryshme të qeveria (në nivele qendrore apo lokale). Taksimi mbështetet në një varg parimesh.

Një parim i rëndësishëm lidhur me taksimin është parimi i përfitimit. Sipas këtij parimi njëri duhet të taksohen në përpjestim me përfitimet që ata sigurojnë nga programet qeveritare. Një parim tjetër i rëndësishëm është parimi i aftësisë për të paguar. Sipas këtij parimi, barra e taksës shpërndahet midis individëve në pajtim me aftësinë e tyre për të paguar, domëthen në pajtim me të ardhurat dhe pasurin e tyre. Parimi i aftësisë për të paguar shpesh interpretohet edhe si parim i barazisë së sakrificave, ku “sakrifika” i referohet humbjes në dobishmërinë e individit për shkak të pagimit të taksës.

Një parim tjetër, që reflekton pikpamjet e sotme mbi drejtësinë, dhe që rrjedh nga parimi i dytë është parimi i drejtësisë horizontale. Sipas këtij parimi, individët me të ardhura (pasuri) të barabarta, duhet të taksohen në mënyrë të barabartë. Parimi i drejtësisë horizontale plotësohet me parimin e drejtësisë vertikale. Sipas këtij parimi, në qoftë se individët me të ardhura (pasuri) të barabarta taksohen në mënyrë të barabartë, individët me të ardhura (pasuri) të pabarabarta duhet të taksohen në mënyrë të pabarabartë.

Taksat mund të jenë të llojeve të ndryshme. Ato mund të jenë proporcionale, progresive ose regresive. Në rastin e taksave proporcionale, përqindja e të ardhurave e paguar si taksë mbetet e pandryshuar me rritjen e të ardhurave. Në rastin e taksave progresive, përqindja e pagura si taksë rritet me rritjen e të ardhurave. Ndërsa në rastin e taksave regresive, përqindja e paguar si taksë ullet me rritjen e të ardhurave. Krahas llojeve të mësipërme, ekziston edhe taksa fikse, masa e të cilave është e përcaktuar dhe nuk varet nga të ardhurat.

Për nga objekti i taksuar, taksat ndahen në *taksa direkte* dhe *taksa indirekte*.



Taksa direkte janë taksat që vendosen direkt mbi individët ose firmat, mbi bazën e të ardhurave, pasurisë apo aftësisë për të shpenzuar. Shembuj taksash direkte janë taksat mbi të ardhurat personale, taksat për sigurimet shoqërore, taksat mbi trashëgiminë, mbi të ardhurat nga kapitali, mbi dhuratat, etj. Edhe taksat mbi korporatat trjtohen edhe si taksa direkte.

Taksat indirekte zakonishtë përcaktohen si taksa që vendosen mbi mallrat dhe shërbime. Megjithatë, “indirekt” edhe këtu taksa rëndojnë mbi individët. Taksat indirekte mund të jenë taksa mbi sasinë ose taksa mbi vlerën (të përcaktuara përkatësishtë në sasi lekësh për njësi fizike të mallit dhe në përqindje ndaj blerës së mallit). Atu mund të jenë gjithashtu taksa fikse, që nuk varen nga sasia apo vlera e mallit dhe e shërbimit. Shembuj taksash indirekte janë taksa mbi qarkullimin, taksa mbi vlerën e shtuar, taksa doganore, akcizat. Në pajtim me nivelet e organizimit shtetërorë, taksat mbliidhen nga qeveria qendrore dhe administratat e pushtetit lokal.

Në praktikë, pothuajse të gjitha taksat shoqërohen me barrë të tepërtë, pra me humbjen neto. Për shembull, një taksë mbi të ardhurat personale do të shoqërohet me humbjen neto, në masën që pakëson stimujt për përmarrjen në punë të individëve të taksuar, duke kushtëzuar edhe humbje të produktit shoqërore (produktit i pa prodhuar), për rrjedhojë edhe humbje në të ardhurat personale. Duke u pakësuar pjesëmarrja në punë, produkti i prodhuar dhe të ardhurat personale, eventualisht do të pakësoheshin edhe të ardhurat nga taksat.

Taksat megjithëse burimi kryesor, nuk janë burimi i vetëm i të ardhurave qeveritare. Qeveria mund të shpenzojë me shumë se të ardhurat e saj prej taksave, duke rezultuar me deficit buxhetor. Deficiti buxhetor mund të mbulohet duke marrë hua. Huaja që merr qeveria mund të jetë hua e mbrendshme, domethënë e marrë nga publiku i mbrendshëm, ose hua e jashtme e marrë nga subjekte, të jashtme. Marrja e huave nga qeveria realizohet përmes lëshimit prej saj të letrave qeveritare me vlerë, si bono thesari, etj., të cilat kontribuojnë në rritjen e borxhit publik.

## 6.4. Zgjedhja publike

Më sipër trajtuam shkurtimisht përmasat absolute dhe relative të sektorit publik. Kjo çështje lidhet me pyetje të tilla si: A përdoren në mënyrë eficientë burimet e alokuar në sektorin publik? Cila është kostoja oportune e sektorit publik?

Të tilla pyetje shtrohen edhe sa herë që është fjala për të zgjedhur midis projekteve të ndryshme brenda sektorit publik. Vetëm shrimi i pyetjeve nënkupton mundësinë që ndërhyrja qeveritare të mos jetë efiçente; ajo mund të dështojë në arritjen e synimeve përkatëse. Pra përballë dështimeve të tregut qëndrojnë dështimet e mundshme të qeverisë. Nga mundësia e dështimit të ndërhyrjes qeveritare, lind nevoja e analizës ekonomike të kësaj ndërhyrjeje. Teorikisht, rruga më e natyrshme për të bërë këtë analizë është krahasimi i përfitimeve dhe kostove të ndërhyrjes qeveritare, të çdo projekti publik në veçanti apo të sektorit publik në përgjithësi. Sipas kësaj metode analize, që quhet thjesht analiza kosto-përfitime, një aktivitet shtesë i sektorit

publik është i dëshirueshëm në qoftë se përfitimet nga ky aktivitet i tejkalojnë kostot e tij oportune, ose të pakten janë të barabarta me to. Kur është fjala për krahasimin e projekteve të ndryshme që i takojnë sektorit publik, sipas kësaj metode do të duhej të zgjidhëshin ato projekte që kanë më të lartë raportin përfitime-kosto. Sidoqoftë, ky raport do të duhej të ishte më i lartë se një raport i caktuar, normativ, i konsideruar si raport minimali pranueshëm.

Sikurse shihet, në parim, analiza kosto-përfitime është mjaft e thjeshtë, por zbatimi i sajë në praktikë është shpesh mjaftë i vështirë lidhen sidomos me vlerësimin e përfitimeve nga aktivitetet të ndryshme në sektorin publik.

Është edhe kjo arsye që në praktikë, në përcaktimin e llojit të mallrave apo shërbimeve që prodhohen në sektorin publik dhe të përmasave të këtij sektori, mbështetemi jo në llogaritjen kosto-përfitime, pa mohuar vlerën ndihmëse të tyre, por në mekanizmin politik. Mekanizmi politik, që në thelbin e tij mund të reduktohet në *mekanizmin e votave* në sitemet demokratike, zëvendëson mekanizmin e tregut lidhur me alokimin e burimeve në sektorin publik dhe, përgjethësisht, lidhur më përgjigjen ndaj pyetjeve të tilla *si çfarë të prodhohet, si të prodhohet dhe për kë të prodhohet* në këtë sektor.

Pyetjet e mësipërme janë objekt i një dege të veçantë të shkencës së ekonomiksit, që duhet *teoria e zgjedhjes publike*. Teoria e zgjedhjes publike studion sjelljen e subjekteve politike, duke konsiderur këtu sidomos votuesit (zgjedhësit) dhe njerëzit e zgjedhur, politikanët. Midis votuesve dhe politikanëve qëndrojnë organizata të ndryshme, që mbrojnë interesat e grupeve të ndryshme.

Toria e zgjedhjes publike i kushton vëmendje të veçantë sjelljes së politikanëve. Krahasuar me mekanizmin e tregut, roli i politikanëve është i ngjashëm me rolin e firmave, sipërmarrësve: ata bëjnë interpretimin e kërkesës publike për të mirat kolektive (publike) dhe përcaktojnë rrugët për sigurimin e këtyre të mirave. Sidoqoftë, një politikë e sukseshme publike mund të jet efektive: ajo mund të sigurojë zgjerimin e mundësive prodhuese të komunitetit, mund të sigurojë një rishpërndarje të drejtë të të ardhurave dhe mund të jetë efiçente.

## 7. Konceptet kryesore makroekonomike

Një koncept kyç makroekonomik është *Produkti i përgjithshëm*, është një mates agregat i vlerës së të gjithë produkteve përfundimtare të prodhuara në një ekonomi. Treguesi i përdorur më gjerësisht i produktit të përgjithshëm është **Produkti i Brenshëm Bruto (GDP)**. Për të llogaritur produktin e përgjithshëm, pra edhe GDP, duhet të dime sasinë e produkteve përfundimtare të prodhuara gjatë periudhës së shqyrtuar dhe çmimet e tyre. Meqenëse çmimet e produkteve ndryshojnë me kaliminë e kohës, për të krahasuar GDP e dy periudhave duhet të

operojmë me çmime të pandryshuara, domethënë me çmimet e periudhës bazë. GDP i llogaritur në këtë mënyrë quhet GDP real. Ndërsa GDP e llogaritur me çmime korrente quhet GDP nominal.

Nevoja për të dalluar shprehjen reale nga nominale e GDP, lidhet me një koncept tjetër të rëndësishëm makroekonomik, **inflacionin**. Inflacioni shpreh rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve dhe matet me anë të normës së inflacionit. Norma e inflacionit shpreh ritmin, në përqindje, të rritjes së nivelit të përgjithshëm të çmimeve gjatë një periudhe të dhënë kohë. Për matjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve, pra dhe ndryshimit të këtij niveli, përdoren disa mënyra, që dallojnë nga shkalla e përfshirjes së drejtpërdrejtë të Produktit të Përgjithshëm. Nga kjo, treguesi me i plotë i ndryshimit të nivelit të përgjithshëm të çmimeve është *deflatori i (GDP)*, pra i cili shprehet si raport i **GDP nominal në GDP real (GDP nominal/GDP real x 100)**, ose diferencë midis ritmeve të rritjes së GDP nominal dhe ritmeve të rritjes së GDP real.


Ritmet e rritjes së GDP real janë tregues i drejtpërdrejtë i ritmeve të rritjes ekonomike, pra edhe i **rritjes ekonomike**, koncepte të tjerë këta shumë të rëndësishëm makroekonomik. Rritja ekonomike është baza e plotësimit të nevojave në rritje të njerëzve.

Domosdoshmëria e rritjes ekonomike buron edhe nga rritja natyrore e popullsisë. Rritja ekonomike krijon mundësinë për zëniën e plotë në punë të popullsisë ekonomikisht aktive. **Punëzënia** dhe **papunësia**, janë ndër konceptet më të rëndësishëm makroekonomike. Shkalla e përdorimit të faktorëve të prodhimit nuk është e njëjtë në çdo kohë. Kështu ndodh edhe me faktorin punë. Ajo pjesë e forces punëtore (pjesës ekonomikisht aktive të popullsisë) që nuk është e zënë me punë, përbën të papunët dhe raporti midis numrit të të papunëve dhe numrit të forces punëtore shprehur në përqindje, përbënë *normën e papunësisë*.

Inflacioni, rritja ekonomike dhe papunësia gjejnë gërshëtimin e tyre në konceptin e **ciklit të biznesit**. Me cikël të biznesit do të kuptojmë modelin e zgjerimit dhe ngushtimit pak a shumë të përsëritshëm (megjithëse jo të rregullt) të aktivitetit ekonomik rreth shtegut të rritjes potenciale. *Shtegu i rritjes potenciale* të GDP shpreh prirjen e GDP në kushtet e përdorimit të plotë të burimeve (faktorëve të prodhimit). Grafiki i ciklit të biznesit dhe shtegu i rritjes potenciale do të shpreheshin si në figuren në vijim.

Ngritja e GDP mbi shtegun e rritjes potenciale mund të ndodhë kur ka mbipërdorim të faktorëve (përsëmbull, punë jasht orarit apo me turne). Diferenca midis produktit potencial dhe produktit aktual përcakton hendekun e prodhimit. Produkti potencial është sasia e mundëshme e produktit në kushtet e punëzënies të plotë. Si koncept ekonomik, punëzënia e plotë nënkupton një fare papunësie që lidhet me proceset përshtatëse të tregut të punës. Papunësia që shoqëronë rënien ciklike të prodhimit quhet papunësi ciklike quhet papunësi ciklike. Lëvizja ciklike e prodhimit nënkupton kalimin e përsëritur nga faza e rritjes në fazën e rënies e kështu me radhë.

GDP real



## 7.1. Objektivat kryesore makroekonomike dhe mjetet politike të realizimit të tyre

Sikur vumë në dukje edhe me sipër, zhvillimi i makroekonomisë si shkencë është i lidhur ngushtsisht me nevojën për të shpjeguar problemet e ndryshme makroekonomike me të cilat ndeshet një ekonomi dhe për të dhënë rekomandimet përkatëse për zgjidhjen e tyre. Të tilla probleme mund të jenë, për shembull rënia ekonomike, inflacioni i lartë, papunsia masive, të cilat mund të shqetësojnë një ekonomi edhe në mënyrë të njëkohshme, sikurse se ndodhi me ekonomitë e vendeve të zhvilluar gjatë gjysmës së dytë të viteve 1970-të, apo sikurse po ndodh me ekonomitë e vendeve të europë qendrore dhe atyre në tranzicion.

Në përpjekjet për tu ruajtur apo rivendosur ekuilibret makroekonomike, një qeveri nisët nga një varg objektivash makroekonomike, në të cilën mishërohen këto ekulibre, për të cilat duhet të perkujdeset qeveria. E atë objektiva janë:

- Punëzënie e plotë
- Qëndrueshmëri çmimesh
- Ritme të përshtatëshme të rritjes afatgjatë
- Zhvillimi i balancuar rajonal
- Bilanci i ekuilibruar pagesash

Le të hedhim një vështrim të shkurtër mbi këto objektiva.

**Punëzënia e plotë**, duke qenë një objektiv i rëndësishëm makroekonomik (përdorimi i plotë i burimeve), është njekohësisht edhe një objektiv i rëndësishëm social, përdërisa punëzënia, përkatësisht papunësia, kanë rëndësi përcaktuese për pozitën sociale dhe mirëqënien e njerëzve.

**Qëndrueshmëria e çmimeve** është e nevojshme sepse pikërisht nëpërmjet çmimeve bëhet e mundur matja, pra dhe krahasimi i vlerave ekonomike. Kur ndodhin ndryshime të shpejta të çmimeve dhe sidomos kur këto janë të pabalancuara dhe të paparashikuara, ndryshojnë raportet midis vlerave ekonomike.

Koncepti i çmimeve të qëndrueshme është i ndryshëm nga koncepti i çmimeve fikse të zbatuar në ekonominë e centralisuar të vendeve ish-socialiste. Mekanizmi i tregut është i papajtuësishëm me çmimet fikse; ai kërkon luhajtjen e lirë të çmimeve në treg. Në këtë kuptim, objektivi i qëndrueshmërisë së çmimeve kërkon jo fiksimin e tyre në nivele të caktuara të pandryshueshme, por thjesht pengimin e rritjeve apo uljeve të mëdha e të shpejta të tyre (është fjala për nivelin e përgjithshëm të çmimeve); ai drejtohet kundër inflacionit të lartë.

**Objektivi i ritmeve të përshtatëshme të rritjes afatgjatë** kërkon optimizimin e këtyre ritmeve mbi bazën e kushteve konkrete dhe duke mbajtur parasysh si përfitimet ashtu edhe kostot e rritjes (të lidhura këto të fundit me mundësinë e përdorimit pa kriter të burimeve, të ndotjes së mjedisit, etj).

**Zhvillimi i balancuar rajonal** është edhe ky një objektiv sa ekonomik, aq edhe social dhe kërkon mbajtjen parasysh në radhë të parë të avantazheve krahasuese të rajoneve të veçanta.

**Sigurimi i një bilanci të ekuilibruar pagesash** është një objektiv tjetër makroekonomik për çdo vend. Bilanci i pagesave shpreh në mënyrë të sintetizuar të gjitha marrëdhëniet ekonomike të një vendi me vendet tjerë. Përveç lëvizjes së mallrave që pasqyrohet në bilancin tregtar, i cili është pjesë përbërëse e bilancit të pagesave, ky i fundit përfshin edhe lëvizjet

afatshkurtra dhe afatgjata të kapitalit. Gjendja e bilancit të pagesave ndikon në treguesit e mbrendshëm makroekonomikë të një vendi

Mjetet që përdor qeveria për realizimin e objektivave të saj ekonomike quhen instrumente politike. Me instrumente politik do të kuptojmë pikërisht një variabël ekonomik nën kontrollin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të qeverisë.

## 7.2. Instrumentet kryesore politike janë

- Politika fiskale
- Politika monetare politika e të ardhurave
- Politika e marrëdhënieve ekonomike me jashtë.

**Politika fiskale** konsiston në përdorimin e taksave dhe shpenzimeve qeveritare si mjete për të ndikuar në treguesit makroekonomikë të një vendi. Shpenzimet qeveritare ndikojnë në nivelin e përgjithshëm të shpenzimeve në ekonomi, pra edhe në nivelin e GDP e për rrjedhojë edhe në nivelin e punëzënies, të inflacionit etj. Shpenzimet qeveritar ndikojnë edhe në përmasat relative të sektorit publik e atij privat. Taksat, parasëgjithash reduktojnë të ardhurat e njerëzve, duke ndikuar kështu në uljen e shpenzimeve për konsum dhe për rrjedhojë edhe të GDP.

**Politika monetare** ushtrohet nga Banka Qendrore, e cila kontrullon ofertën monetare duke ndikuar kështu në nivelin e normave të interesit. Norma e interesit, nga ana e tyre, ndikojnë të niveli i investimeve, te niveli i i konsumit të mallrave të perdorimit afatgjatë, te kurset e këmbimit valutor, etj. Ndjekja e nje politike të shtrenguar monetare gjatë periudhës së tranzicionit në vëndin tonë ka synuar në frenimin dhe uljen e ritmeve të inflacionit.

**Politika e të ardhurave**, që quhen ndryshe politika pagë-çmim, nga një numër ekonomistësh konsiderohen si politika alternative ndaj politikave fiskale dhe monetare të përdorura tradicionalisht si mjete të luftës antiinflacioniste. Përkrahësit e politikave të të ardhurave përdorin si argument koston e lart të politikave tradicionale. Për shembull, sipas disa vlersimeve, për çdo pikë përqindje të uljesë së inflacionit nëpërmjet përdorimit të politikave tradicionale, hendeuku i prodhimit në SH.B.A rritet disa qindra miliardë dollarë. politikat e të ardhurave përfshin një spektër të gjerë masash që shkojnë nga kontrolli i fortë i pagave dhe çmimeve nga qeveria, deri tek thirrjet ndaj sendikatave dhe firmave

### Ndër politikat e jashtme ekonomike po i veçojmë:

Politikat tregtare, që konsistojnë në përdorimin e mjeteve tarifore dhe jo tarifore për kufizimin, përkatësisht stimulimin, e importit dhe eksportit. Në kushte të caktuar politikat tregtare kanë ndikim të rëndësishëm në gjendjen makroekonomike të një vendi.

Politikat valutore, që konsistojnë në regjimet valutore që zbaton një vend. Spektri i këtyre politikave është mjaft i gjerë dhe shkon të mosndërhyrja e qevëris në tregun valutor, duke ja lënë plotësisht tregut përcaktimin e kurseve të këmbimit, deri në vendosjen e kurseve fikse ndaj valutave të tjera. Kursi i këmbimit i një valute perfaqëson çmimin e kësaj valute në terma të valutave të tjera. Kur vlera e valutës së një vendi rritet eksportet e këtij vendi bëhen më të shtrenjta, pra dhe me pak konkurese në tregjet botërore, duke shkaktuar këqesimin e bilancit tregtar dhe të pagesave. Kur vlera e valutës së vendit ullet, eksportet stimulohen, ndërsa importet, si rregull, frenohen duke ndikuar në përmisimin e bilancit tregtar dhe të pagesave. Megjithatë ulja e vlerës së valutës së një vendi mund të ketë pasoja të tjera të pa dëshirueshme makroekonomike për një vend. Për shembull, në kushtë të një vendi po kalon vendi ynë, zhvlersimi i lekut do të pasqyrohej drejtpërdrejt në rritjen e normës së inflacionit.

Koordinimin e politikave të mbrendshme makroekonomike të vendeve të veqanta e kushtezuar kjo nga shkalla e lartë e varësisë ekonomike, (takimi i shtatë vendet e mëdha të industrializuar) japin një dëshmi të qartë. Përshkak të kompleksitetit të një situatë të caktuar ekonomike, një qeveri, si rregull, do të ndjekët njeherësh disa objektiva makroekonomike. Mëgjithatë jo rrallë qeveria mund të jetë e detyruar të zgjedhë mjedisin objektivave të ndryshme për shkak të kundervënjeve të mundshme mjedisi i tyre, duke qenë kështu e detyruar të zgjedhë edhe mjedis politikave alternative. Në një lidhje të tillë kontradiktore janë, për shembull, objektivi i punëzënjës së plotë dhe objektivi i qëndrueshmërisë së çmimeve. Përpjekjet për uljen e inflacionit mund të shoqërohen me koston e një papunësie të lartë.

### 7.3. Instrumentet kryesore të analizës makroekonomike

Në analizën makroekonomike është e rëndësishme të mbajmë parasysh ndërvarësinë midis anave të ndryshme të organizimit ekonomik. Megjithatë, për shkak të pamundësisë për të përfshirë në analizë në mënyrë të shprehur të gjitha lidhjet, modelet teorike makroekonomike mbështeten mbi abstraksione të caktuara, në përpjekje për të bërë të mundur përfdhirjen e lidhjeve më të përgjithshme makroekonomike procesi i zbulimeve dhe i evidencimit të lidhjeve më të përgjithshme makroekonomike kërkon agregimin e treguesve ekonomikë, ndërtimin e treguesve përgjithësues makroekonomikë. Tregues të tillë, ndër të tjerë, janë kërkesa agregate dhe oferta agregate, që përbejnë dy nga konceptet dhe instrumentet më të rëndësishëm makroekonomikë.

**Kërkesa agregate (AD)** i referohet sasisë së përgjithshme të produktit që konsumatorët, firmat, shteti dhe të huajt janë të gatshëm të konsumojnë (kërkojnë) me një nivel të dhënë agregate të çmimeve në një periudhë të dhënë kohe. Pra kërkesa agregate mat shpenzimet e përgjithshme të të gjithë agjritëve ekonomikë, për të gjithë mallrat e konsumit, shërbimet, mallrat kapital, mallrat e blera nga qeveria, mallrat e blera të huajt. Duke qenë një tregues kompleks, kërkesa agregate ndikohet nga faktorë të shumtë, si çmimet e mallrave e shërbimeve,



të ardhurat e njerëzve, kushtet financiare, pritjet për të ardhmen, konditat e jashtme ekonomike, politikat qeveritare, etj.

**Oferta agregate (AS)** i referohet sasisë së përgjithshme të produktit që firmat planifikojnë të prodhojnë dhe të shesin me një nivel të dhënë agregat të çmimeve, në një periudhë të dhënë kohe. Edhe oferta agregate, si tregues kompleks, ndikohet nga një varg i gjatë faktorësh, si niveli i çmimeve, kapaciteti prodhues të firmave, niveli i kostove, etj. Koncepti i ofertës agregate nuk duhet ngatërruar me konceptin e produktit potencial, megjithë lidhjen e ngushtë që ekziston midis tyre.

Barazimi i ofertës agregate me kërkesen agregate ( $AS=AD$ ) përbën kushtin kryesor të **ekuilibrit makroekonomik**. Në kushtet e këtij barazimi, produkti i përgjithshëm do të jetë në nivelet që firmat me dëshirën e tyre u shesin blerësve sipas dëshirës së tyre, kur është i dhënë niveli i çmimeve.

## 7.4. KONSUMI DHE INVESTIMI

Konsumi përfaqëson shpenzimet për blerjen e mallrave prej të cilave nxjerrët dobi në periudhën e tanishme (korrente), pjesa tjetër e të ardhurave të disponueshme që nuk shpenzohet për konsumim paraqet konsumin. Dihet se konsumi (C) përbën komponentin më me peshë të kërkesës agregate dhe të GDP njëkohësisht kur niveli i të ardhurave të disponueshme është i ulët, konsumatorët do të jenë të prirur që shumicën e këtyre të ardhurave të shpenzojnë për gjërat të domosdoshme si ushqimi ‘strehimi etj. Mirëpo me rritjen e të ardhurave më shumë do të rriten kërkesat për mallrat e luksit. Nga ana tjetër proporcionalisht me të ardhurat do të rriten shpenzimet për veshje, argëtim, etj. Po ashtu me rritjen e të ardhurave, rritjen të shpejtë e pëson kursimi, dhe me këtë mund të konkludojmë se të pasurit kursejnë më shumë se të varfëritë. Nga kjo del se faktori i parë përcaktues i konsumit dhe kursimit janë të ardhurat e disponueshme. Kjo varësi e konsumit dhe e kursimit nga të ardhurat e disponueshme është analizuar më gjerësisht nga Kejnisi dhe njihet si hipoteza e **“të ardhurave absolute”**

Tabela 3.1 .të ardhurat e disponueshme,,konsumi,kursimi.

Të ardhurat e disponueshme në (E)	Konsumi	Kursimi
250	210	40
200	170	30
150	130	20
100	90	10

50	50	0
0	10	-10

## II. Fakëtorë të tjerë përcaktues të konsumit,

Pos të ardhurave të disponueshme faktorë tjetër influencues në nivelin e konsumit është edhe pasuria e cila ka ndikim të madh sidomos kur ajo ndryshon shpejt dhe në përmasa të mëdha. Për të kuptuar ndikimin e pasurisë në konsumin e agregat do të ishte e dobishme që të mbanim parasysh analizën mikroekonomike të zgjedhjes së konsumatorit individual midis konsumit present dhe atij të ardhshëm. Për thjeshtësi, supozojmë vetëm dy periudha kohë, përfundim të pranishme dhe përfundim të ardhshme.

Konsumi nuk varet vetëm nga të ardhurat e disponueshme, por edhe nga faktorë të tjerë si: pritjet për të ardhurat, çmimet, taksat etj. Pra, konsumi pos nga të ardhurat e disponueshme varet edhe nga pritjet afatgjate të ardhurave, duke i marrë në konsideratë edhe të ardhurat e shkuara dhe ato të ardhshme. Teoria kryesore që argumenton këtë varësi është hipoteza e "të ardhurave permanente" e ekonomistit të shquar amerikan, Milton Friedman. Konceptet bazë me të cilat operonte Friedman janë: konsumi permanent, të ardhurat permanente, dhe të ardhurat tranzitore, sipas hipotezës së të ardhurave permanente konsumi permanent është proporcional me të ardhurat permanente.

Konsumi permanent dhe të ardhurat permanente përfaqësojnë pritjet afatgjate të konsumit dhe të ardhurave. Sipas Friedmanit të ardhurat aktuale mund të jenë më të mëdha ose më të vogla se të ardhurat permanente, dhe diferenca në mes tyre paraqet të ardhurat tranzitore. Të ardhurat tranzitore paraqesin rritjen ose rënien e pa pritjet të të ardhurave që janë të pavaruara nga të ardhurat permanente.

### 7.5. Investimet dhe faktorët përcaktues të tyre

Shpesh me investime nënkuptohet çdo shpenzim për blerjen e ndonjë pjese të tokës të, të letrave ekzistuese me vlerë, etj. Mirpo në këto raste kemi të bëjmë vetëm me transaksionet financiare, kurse në kuptimin e ngushtë ekonomik investim kemi vetëm atëherë kurë krijohet kapitali i ri real, pra kur kemi shtesa të stokut fizik të kapitalit si: makinerit dhe pajisjet, ndertesat dhe shtesë inventari. Roli i rëndësishëm makroekonomik i investimeve lidhet së pari me faktin që investimet përmbajnë një zë me peshë dhe shumë të ndryshueshëm të shpenzimeve totale dhe së dyti me faktin që investimet influencojnë drejtëpërdrej produktin potencial. Faktorët që ndikojnë në investime janë të shumtë mirëpo ne do të ndalëmi në dy teori kryesore lidhur me funksionin e investimeve, teorinë që lidhë investimet me normat e interesit dhe teorinë e përcaktimit të investimeve nga të ardhurat që quhet ndryshe teoria e akselatorit (përshejtimit).

## 7.6. Investimet dhe normat e interes

Norma e interes është njëri ndër faktorët kryesorë që ndikon tek investimet, dhe paraqet koston apo qmimin e kapitli të marrë hua. Pra norma e interes paraqet qmimin të cilin duhet t'ia paguaj huamarrësi huadhënësit për kapitalin e e marrë hua .Një investim është I pranueshëm vetëm në qoftë së përfitimet e pritura nga ky investim kalojnë koston e tij, ose të pakëtën janë të barabarta me të .Sipas kësaj që thamë ,sa më e lartë të jetë norma e interes aq me e lartë është kostoja e investimit dhe aq më I vogel investimi

## 8. CIKLET E BIZNESIT DHE RITJA EKONOMIKE

Historia e zhvillimit ekonomik e vendeve të zhvilluara kapitaliste, tregon se ekonomia nuk rritet e zhvillohet pa problem. Vitet e ekspansionit dhe mirëqëniesë ekonomike ia lënë vendin e viteve të recensionit ose të panikut ekonomik. Këto luhatjet të ekonomisë, here në ekspansion dhe here në recension, që karakterizohen respektivisht nga lëvizjet në ngritje dhe ulje të produktit total, inflacionit, norms së interes dhe punësimitë krijonë të ashtuquajturit **cikle të biznesit**. Ciklet e biznesit përbëjnë thembrën e Akilit për ekonominë kapitaliste.

### I. Cikli i biznesit dhe fazat e tij

Zhvillimi ekonomik i vendeve me një ekonomi tregu të zhvilluara megjithëse karakterizohet nga një prirje rritje, në kohë të caktuara ka patur shmangie nga kjo prirje e përgjithëshme, duke u karakterizuar here nga perudha të rënies ekonomike dhe herë nga periudha të rritjes ekonomike janë ato të viteve: 1929-1933, 1937-1938, 1948-1949, 1953-1954, 1960-1961, 1973-1975, 1981-1982.

Ekzistenca e periudhave të rënies dhe ngritjes ekonomike, provon se kushtet e biznesit nuk janë të pa ndryshueshme. Rritja ekonomike nuk arrihet asnjëherë me një koficient rritës konstant, ajo karakterizohet nga shmangiet e lartë ose poshtë prirjes së përgjithëshme të rritjes. Bumi ose ngritja ekonomike mund të ndiqet nga paniku dhe renja ekonomike, ekspansion ja le venin recensionit në të cilinë niveli i GDP, punësimit dhe i të ardhurave reale bien, fitimet e firmave gjithashtu reduktohen dhe shumë të punësuar shndërrohen në të papunë.

Kur përfundon faza e rënies ekonomike, fillon faza e rritjes ekonomike ose ekspansioni ekonomik, e cila mund të jetë e shpejtë ose e ngadalshme. Në këtë faze GDP, niveli i punëzënies, të ardhurat reale dhe fitime te firmave rriten. Më pas cikli fillon të përseritet me rëniet dhe ngritjet ekonomike alterntivat kundrejt pritjes së përgjithshme të rritjes ekonomike.

**Këto lëvizja here drejt rënisë dhe here drejtë ngritjes të treguseve kryesorë ekonomikë kundrejtë një prerjeje të përgjithshme në rritjen ekonomike formojnë ato që quhenë cklet e biznesit.**

Fluktacionet ose lëkundjet e aktivitetit real ekonomik megjithëse emërohenë si cikle, në të vërtetë nuk formojnë cikle të rregullta. Nuk ka recensionë (rënie) apo ekspansionë (ngritje) ekonomike të ngjashme. Ekonomia nuk është si lavjersi i sahatit dhe lëkundjet nuk janë kaq të rregullta e të përcaktuara siç janë, për shembull orbitat në të cilat lëvizin planetet e sistemit diellor.


Megjithatë, edhe pse ciklet e biznesit dallojnë nga njëri tjetri, ato kanë diçka të përbashkët. Çdo cikël biznesi karakterizohet nga disa faza të njëllota.

Ekonomistët që merren me studiminë e cikleve të biznesit kanë përcaktuar katër faza të ciklit të biznesit:

1. Pika më e lartë e ciklitë
2. Faza e recesionit (rënies ekonomike)
3. Pika më e ulët e ciklitë
4. Faza e ekspansionit (ngritjes ekonomike)

Figura 1.1 paraqet në manure grafike katër fazat kryesore të një cikli biznesi. Edhe nga paraqitja grafike vëmë re se mënyra e sjelljes të një cikli të biznesit është e parregullt. Grafiku na tregonë se ciklet e biznesit janë si një bashkësi malesh dhe luginash me nivele të ndryshme lartësish. Disa luginat janë shumë të thella, siç ndodhi në kohën e depresionit të madh viteve 1929-1933, kurse disa janë të cekta, siç ishte ajo e vitit 1970 për ekonominë amerikane. Edhe zgjatja e fazave ndryshon nga njëri tjetri.

Figura 17.1. Ciklet e biznesit



Momenti kyq, për të identifikuar një cikël të biznesit, është përcaktimi i fazes së recensionit pra, përcaktimi i periudhës kur aktiviteti ekonomik është në rënie. Duhet të theksojmë se jo çdo rënie ekonomike mund të karakterizohet si një recension. Rëniet momentale ose rëniet ekonomike për periudha shumë afat shkurta nuk përbëjnë recension ekonomik.

Pranohet se kemi të bëjmë me një fazë të recensionit ekonomik vetëm atëherë kurë GDP real bie gjatë dy tremujorëve të një pasnjëshëm kalendarike (ose për gjashtë muaj rresht). Gjatë periudhës së recensionit firmat dhe konsumatorët i ulin nivelet e shpenzimeve të tyre. Firmat, për shkak të inventarëve të tepërta (stoqeve të mallrave të pa shitura), reduktojnë prodhimin, pakësojnë shpenzimet për lëndët e para, reduktojnë shpenzimet për investime, dhe nxjerrin jashtë nga puna një numër të caktuarë punëtorësh.

Rrjedhimisht, edhe fitimet e firmave bien, por edhe në këto kushte disa firma vazhdojnë të qëndrojnë në biznes, kurse disa të tjera duke mos qenë në gjendje ti bëjnë ballë kësaj situatë, dalin nga biznesi, ose falimentojnë.

Periudha e recensionit përfundon me arritjen e pikes më të ulët të ciklit të biznesit. Në këtë pikë firmat punojnë me kapacitet jo të plotë dhe niveli i përgjithshëm i papunësisë arrinë nivelin më të lartë. Prodhimi total i të mirave dhe shërbimeve vazhdon të ulet. Në këtë fazë të ciklit është shumë vështirë të gjendet punë sepse shumë firma dalin nga biznesi, falimentojnë.

Praktikishtë, përcaktimi i kësaj faze të ciklit është i vështirë dhe nuk ka ndonjë përkufizim të pranohet nga të gjithë ekonomistët. Megjithatë, shpesh here si treguesë i identifikimit të saj merret norma e lartë e papunësisë, ndoshta në nivel dyshifrore.


Pas disa kohësh, ekonomia fillon të rimarrë vetën përsëri, duke hyrë në fazën e ekspansionit ose të rritjes ekonomike. Gjatë fazes së ekspansionit shpenzimet e firmave dhe të konsumatorve fillojnë të rriten. Firmat fillojnë të zgjerojnë prodhimin, papunësia fillonë të ulet, pajtohen punëtoret në punë, të ardhurat fillojnë të rriten, rritet në këtë mënyrë kërkesa konsumatore, gjë e që influencon në rritjen e mëtejshme të prodhimit, të punëzënies, të konsumit, e tj.

Faza e ekspansionit përfundonë me arritjen e pikes më të lartë të ciklit. Në këtë faze përfundonë me arritjen e pikesë më të lartë të ciklit. Në këtë faze ekonomia është në bumin e vet ekonomik. Firmat normalisht prodhojnë afër ose në kapacitetet e tyre prodhuese dhe ata që kërkojnë punë përgjithësisht mund ta gjejnë një të til. Investimet e firmave dhe shpenzimet konsumatorëve janë në nivelin e yre më të lartë. Porë meqenëse ekonomia punonë me afer ose në nivelin e punësimit të forte të faktorve të prodhimit rritja e mëtejshme e kërkesesë përë të mira e shërbime do të çojë në rritje e nvelit të përgjithshëm të çmimeve.

## 8.1. Rritja ekonomike

Nga analiza që i bëmë cikleve të biznesit, rezultonë se në një ekonomi tregu të konsoliduar, megjithëse vërehen luhatjet në formën e reçonsonit dhe të ekspansionit, tendenca e përgjithshme është **rritja e ekonomisë**. Në periudha aftshkurtëra gjendja e ekonomisë mund të karakterizohet me njërenë nga katë fazat e ciklit kurse në periudha afatgjata ajo karakterizohet nga tendenca drejt rritjes ekonomike. Analizat e rritjes ekonomike shqyrtojnë faktorët që çojnë në rritjen ekonomike në një periudhë afatgjatë. Duke qenë se oferta aggregate përcaktohet nga aftësitë që ka ekonomia e një vendi për të prodhuar mallra dhe shërbime, domethënë nga podhimi i saj potencial, atëherë analiza e rritjes ekonomike shqyrton faktorët të cilët çojnë në rritjen e prodhimit potencial në një periudhë afatgjatë.

Rritjen ekonomike munda ta përcaktojmë si një ekspansion në GDP potencial të një vendi. Me fjalë tjera, rritja ekonomike përcaktohet si aftësi e ekonomisë së një vendi për të prodhuarë gjithnjë e më shumë mallra e shërbime që dëshirojnë konsumatorët.



Rritja ekonomike konsiderohet si një ndër objektivat qëndrore stabilizuese makroekonomike. Kjo për vetë faktinë se rritja ekonomike lidhet ngushtë me standartin e jetesës së popullsisë së një vendi. Një rritje në standartin e jetesës në rritjen e popullsisë kërkonë medoemos rritjen e prodhimit të mallrave dhe të shërbimeve. Një tregues i rëndësishëm i standartit të jetesës do të ishte *prodhimi për frymë të popullsisë*. Do të konsiderohet përmirësim i standartit të jetesës së popullsisë të një vendi atëherë kur çdo individ, me kalimin e kohës, ka në dispozicionë të tij më shumë mallra e shërbime për të konsumuar se sa më parë.

Analizat e rritjes ekonomike, bazuar në prodhimin për frymë popullsisë, kërkojnë që të mbahen parasysh jo vetëm ndryshimet që ndodhin në GDP potencial të një vendi por edhe ndryshimet në numrin e popullsisë të këtij vendi. Sepse, në qoftë se popullsia rritet me ritme më të shpjta sesa prodhimi dhe kapacitetet podhuese atëherë nuk do të kemi asnjë përmirësim në standartin e nivelit të jetesës së popullsisë. Prandaj, një mates kuptimplotë i rritjesë ekonomike mbetet *niveli i prodhimit real përë frymë të popullsisë*.

Që në hapat e para të lindjesë së ekonomiksit, ekonomistët janë përpjekur të shpjegojnë evolucionin e prodhimit dhe të pages si dhe procesin afatëgjatë të rritjesë ekonomike në pëgjithësi. Kështu modelet klasike të paraqitura nga Adam Smith dhe Tomas Maltus e përshkruajnë zhvillimin ekonomik duke anaizuar lidhjen që ekziston midis burimit të prodhimit, që për ta ishte toka, dhe rritjesë së popullsisë.

Smithi në veprën e tijë “Pasurija e Kombeve” bën fjalë për një epokë të artë e cila i paraprinte përvetësimtë të tokave dhe akumulimit të kapitalit, në të cilën vetemë puna merrej parasysh, kurse toka ishte e lirë në dispozitcion të të gjithëve.

Në këto kushte prodhimi dhe çmimet varshin nga ose percaktoheshinë vetemë nga puna. Çdo mall tregëtohej me çmimet, të cilat ishin propocionale me punën e harxhuar për prodhimin e tyre Pra çmimet ishinë përcaktoheshin me koston mesatare të punës së harxhuar për prodhimin e mallrave. Në qoftë se prodhimi rritet në të njejtinë përpjestimë me numrin e popullësisë, atëherë nuk do të veprojë ligji i të ardhave zbritëse dhe paga reale për puntorë do të mbetet konstante. Kjo situatë do të vazhdojë të jetë e tillë derisa një shpikës të gjejë një metodë të re për të prodhuar në një orë atë që më parë prodhohej, për shembull, në dy orë. Kjo padyshim do të rriste prodhimin për frymë të popullësisë. Një përmisim i balancuar në produktivitetin e punës mund t'i lërë raportet e çmimeve të pandryshuara, por ai mund të dyfishojë pagën reale. Në një botë të tillë ku sundon teoria e percaktimit të vleresë nga puna shpikjet e reja mund të qojnë në rritjen e pagave dhe të shpejtojnë ritmet e rritjes ekonomike.

Por kjo epokë e re e “artë” nuk mund të vazhdojë për shumë kohë. Në kushtet kur toka popullohet plotësisht ( nuk ka me toka të lira) rritja e balancuar e tokës dhe e punës së bashku me prodhimin është e pa mundur. Toka si një faktor kyesor i prodhimit bëhet një faktor i rrallë dhe me rritjenë e popullsisë prodhimi mund të rritet më me ngadalë. Punëtorë të rinjë shtohen (punojnë) në një sipërfaqe toke të pandryshuara, rrjedhimisht çdo punëtor ka në dispozicion më

pak se tokë për puntor ka në dispozicion më pak tokë për të punuar. Në këto kushte fillon veprojë ligji i të ardhurave zbritëse. Rritja e raportit punë-tokë qonë në uljenë e pages.

## 8.2. INFLACIONI

Inflacioni përbën një ndër smundjet makroekonomike dhe konsiderohet si një problem shqetësuese për ekonominë në tërësi dhe për firmat dhe konsumatorët në veçanti. Për këtë arsye çdo qeveri problemin e inflacionit e konsideron si një ndër pikat kryesore stabilizuese makroekonomike.

### I. Kuptimi i inflacionit

Në këndvështrimin e problemeve që studion Makroekonomia, një vend të veçantë zë dhe tema e inflacionit. Dukuria e inflacionit së bashku me papunësinë përbëjnë një “smundje të rëndë” makroekonomike. Kurimi sa më i mirë i sëmundjes kërkon para së gjithash të njihet mirë sëmundja. Pra çështje inflacioni?

*Me inflacion do të kuptojmë ngritjen e vazhdueshme të nivelit të përgjithshëm të çmimeve.* Ndryshimi i nivelit të çmimeve matet me normën e inflacionit e cila llogaritet si më poshtë:

$$\text{Norma e inflacionit}_{(t)} = \frac{\text{Niveli i çmimeve (t)} - \text{Niveli i çmimeve (t-1)}}{\text{Niveli çmimeve (t-1)}} \times 100$$

Ku  $t$  është periudha korente dhe  $t-1$  është periudha parardhëse.


Siç del dhe nga përkufizimi i mësipërmë, është e domosdoshme të theksojmë se inflacioni është një dukuri ekonomike që shpre *ngritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve* dhe jo të çmimeve të mallrave apo të shërbimeve të veçanata. Me ngritje të nivelit të përgjithshëm të çmimeve ngelim parasysh *ngritjen e nivelit mesatar të tyre*. Natyrishtë, jo të gjitha çmimet ngrihen në të njetën masë gjatë gjatë periudhës së inflacionit.

Disa çmime ngrihen më shumë ndërsa të tjerë ngrihen më pak, sidoqoftë në një situatë *inflacioniste nivelin mesatar* i se çfarë përfaqësojnë këto indekse çmimesh.

### I.

### Indeksi i çmimeve të konsumatorit

(CPI) është treguesi që përdoret më gjerësisht për matjen e inflacionit. *CPI mat koston e një shporte tregu mallrash dhe shërbimesh që konsumohen nga një familje tipike*





qytetare gjat një periudhe të caktuar kohe. Në SHBA kjo shportë tregu përfshin rreth 365 llojesh mallrash dhe shërbimesh dhe për të llogaritur CPI mbledhen të dhëna për 21.000 familje qytetare në 91 zona të vendit. Kjo shport vlersohet me çmimet e mallrave dhe të shërbimeve në periudha të ndryshme kohe. Në përlogaritjen e CPI mbahen parasysh edhe *peshat specifike të çdo mali apo shërbimi në buzhetin e shpenzimeve të konsumatorit.*

## II. **Indeksi i çmimeve të prodhuesit.** Ky

indeks mat nivelin e çmimeve të shitjes me shumicë, pra nivelin e çmimeve në stadin e prodhimit. Në rastin e SHBA-ve ky indeks llogaritet duke u bazuar në çmimet e rreth 3400 mallrave të ndryshme. Llogaritja e indeksit të çmimeve të prodhuesit është i rëndësishëm për shkak të gjerësisë së mallrave dhe të shërbimeve që ai përfshin. Ai përdoret gjerësisht në veprimtarinë tregtare.

## III. **Deflatori i GNP.** Me konceptin e deflatorit të GDP-së jemi njohurë shkurtimisht edhe në temat e kaluara. Kujtojmë se deflatori i GD-së real, shprehur në përqindje, pra:

$$\text{Deflatori i GNP} = \frac{\text{GNP nominal}}{\text{GNP real}} \times 100$$

Ky raport mund të interpretohet si një indeks më i përgjithshëm i çmimeve përderisa ai përfshin çmimet e gjitha mallrave dhe të shërbimeve. Për këto arsye ekonomistët e konsiderojnë deflatorin e GNP si një matës më të mirë të inflacionit se sa Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit (CPI) dhe Indeksi i Çmimeve të Prodhuarit (PPI)

Shpesh herë në mesë njerëzve lindin lindin keqkuptime krijohet konfuzion në lidhje me inflacionin. Këtu po paraqesim disa pyetje të cilat të cilat reflektojnë keqkuptimet e përbashkëta, së bashku me përgjigjet e tyre:

1. A i bënë inflacioni mallrat dhe shërbimet më të shtrenjta? Jo. Inflacioni do të thotë që niveli mesatar i Çmimeve ngrihet. Shtrenjësia e mallrave lidhet me çmimet relative të tyre, të cilat jo me domosdoshmëri ndryshojnë.
2. A na bënë inflacioni më të varfër? Jo pa tjetër. Të ardhurat tona nominal tentojnë të rritenë gjatë periudhës së inflacionit ndërkohë që të ardhurat tona reale mund të rritenë sikurse mund të mos ndryshojnë apo të ulen po gjatë kësaj periudhe.
3. A bëhen firmat më të pasura dhe puntoret më të varfur gjatë periudhës së inflacionit? Jo patjetër. Efekti i inflacionit në shpërndarjen e të ardhurave varet nga lloji i inflacionit, të cilat do t'i analizojmë më poshtë.

## II.Llojet e inflacionit

Në përgjithësi në teorin ekonomike inflacioni klasifikohet ë tre kategori:

- a) Inflacioni i moderuar.
- b) Inflacioni galopant.
- c) Hiperinflacioni.

Karakteristikat kryesore të këtyre kategorive të inflacionit po i paraqesim më poshtë:

**Inflacioni i moderuar.** Ky llojë inflacioni ndodh kurë niveli i përgjithshem i çmimeve ngrihet ngadalë.Kemi të bëjmë me inflacion të moderuar kur norma e tij shprehet me anën e një numri njëshifror.Në këto kushte çmimet janë relativisht të qëndrueshme dhe njerëzit kanë besim tek paraaja, janë të gatshëm t'i mbajnë ato në duart e tyre ose t'i depozitojnë në banka, duke pranuar edhe norma interesi shumë të ulëta.

Gjithashtu, individet janë të gatshëm të nënëshkruajën kontrata me vlera monetary, nisur nga qendrushmeria e çmimeve. Ata nuk humbasin kohën duke u përpjekur që pasurin e tyre ta vendosin në pasuri reale në vend të asajë monetare ose në formën e letrave me vlerë, sepse kanë besim pasuria e tyre në formën monetare do ta ruajnë vlerën e saj reale. Shkurt mund të themi se në një situatë me inflacion të moderuar sistemi monetar funksionon mirë.

**Inflacioni galopant.** Kemi të bëjmë me këtë llojë atëherë kur niveli mesatar i çmimeve fillonë të rritet me një normë dy ose tre shifrore, përsëherë, 20%, 100%, 200%, në vit. Kur ekonomia është në një situatë të tillë ndodhin shtrembime serioze në treguesit ekonomik dhe financiarë. Besimi tek paraaja lekundet dhe bie. Përgjithësisht shumë kontrata indeksohen me indeksin e çmimeve ose në valuta të huaja, përsëherë në dollarë. Meqenëse parat humbasin vlerën e tyre shumë shpejt dhe meqenëse norma e interesit merr vlera shumë të ulëta ose negative, njerëzit shmangen mbajtjes së parave në duart e tyre mbi një minimum të domosdoshëm. Tregu financiar dhe roli i normës së interesit dopsohet shumë. Njerëzit priren të grumbullojnë apo depozitojnë mallra, të blejnë shtëpi ose forma të tjera të pasurisë së patundshme dhe nuk japin kurrë hua me një normë interesi të ulët.

## 9. PAPUNËSIA

Papunësia përbën një ndër sëmundjet më të rënda makroekonomike. Shpesh herë, rritja e treguesit të papunisë konsiderohet si një simptomë e fazës së recesionit ekonomik. Prandaj analiza teorike e saj merr një rëndësi të veçantë, sepse na lejon të përcaktojmë drejtë edhe medikamentet, politikat përkatëse për ta shëruar këtë sëmundje.

Në pjesën e parë të këtij kreu, analizojmë kostot e papunisë dhe më pas, duke paraqitur treguesit kryesorë të tregut të punës, jepet metodika e matjes së saj, nëpërmjet llogaritjes së normës së

papunësisë. Duke pasur parasysh rëndësinë që kanë politikat e reduktimit të papunësisë, në pjesën e dytë bëhet interpretimi ekonomik i papunësisë dhe paraqiten llojet kryesore të saj. Në pjesën e tretë analizohet një kategori e rëndësishme e tregut të punës, norma natyrore e papunësisë.

## I. Papunësia , matja dhe kostot e saj

Analizën teorike po e fillojmë me kostot e papunësisë, sepse ato nxjerrin më mirë në dukje thelbin e saj. Kostot e papunësisë i klasifikojmë në dy grupe kryesore:

- a) **Kostot ekonomike të papunësisë.** Nga pikpamja ekonomike një papunësi e lartë do të thotë rënje në GDP aktual, pra treguesi i GDP aktual është më i vogël se sa treguesi i GDP potencial. Sa më e madhe të jetë papunësia aq më i madh hendeku midis GDP aktuale dhe GDP potencial. Lidhja midis papunësisë dhe GDP jepet nga ligji Okun, sipas të cilit, siç e vumë në dukje në temen e kaluar, për çdo 2% të rënies së GDP aktuale në krahasim me GDP potencial, norma e papunësisë rritet me 1%. Për shembull, në çoftëse GDP potencial është 100 %, norma e papunësisë është 6 % dhe GDP aktual bie në masën 96% të GDP potencial, atëher norma e papunësisë do të rritet nga 6% në 8%.

Në krahasim me burimet e tjera të prodhimit, puna mund të konsiderohet si burim më pak i rezervueshëm. Një ditë punë e humbur për shkak të papunësisë, është humbur përgjithmonë dhe nuk mund të rifitohet. Kjo karakteristikë e faktorit punë u jep karakter absolut humbjeve ekonomike nga papunësia. Nga studimet që janë bërë, humbjet ekonomike të shkaktuara nga papunësia vlersohen të jenë më të mëdha edhe sesa humbjet që pëson shoqëria nga ineficiencia e monopoleve apo nga humbjet e shkaktuara nga tarifrat dhe kuotat. Në këto kushte, norma e papunësisë bëhet një matëse e shendetit ekonomik të një vendi.

Kostoja ekonomike e papunësisë shprehet, në këndvështrimin makroekonomik, në hendekun e prodhimit, pra në diferencën midis produktit aktual dhe atij potencial. Kuptohet, në situata papunësie kjo diferencë merr vlera negative.

Një aspekt tjetër ku shfaqen kostot e papunësisë, është dhe fakti se të papunët janë një barrë e rëndë financiare për qeverinë, sepse është kjo e fundit që përballon fondet për dhënie ndihme financiare për të papunët.

Zvoglimi i të ardhurave personale, si rezultat i humbjes së vendit të punës, për një kryefamiljar përbën një kosto të dukshme ekonomike të papunësisë, por tashmë parë nga pikpamja mikroekonomike. Një gjendje e tillë çon në uljen e nivelit të jetesës të të papunet dhe të familjes së tij, mbasi tani ata do të konsumojnë më pakë të mira dhe shërbime.

- b) **Kostot sociale të papunësisë.** Krahas kostove ekonomike, për të cilat folëm më lartë, papunësia shoqërohet edhe me kosto sociale, të cilat edhe pse është e vështirë të shprehen në vlerë, nuk janë më pak se të parat. Kostot sociale të papunësisë mund të paraqiten në disa forma:

Papunësia shkakton zhvlersimin e kapitalit human. Një papunësi e zhgatur e ulë në mënyrë serioze vlerën e një investimi të kryer në kapitalin human. Ndodh kështu sepse

shkalla e arsimit e fituara dhe e aftësis për punë, e humbasin vleren e tyre kur nuk vihen në përdorim për një kohë të gjatë.

Rritja e papunësisë mund të shërbejë si shtrat i ngrohtë për rritjen kriminalitetit në shkallë vendi. Një rritje në numrin e të papunëve mund të shkaktojë rritjen e numrit të krimeve.

Kur individët nuk marrin të ardhura nga një punë e ligjshme, atëherë ata mund të priren t'u drejtohen rrugëve të paligjshme, pra rrugëve të krimit.

Kostot sociale të papunësisë marrin edhe formën e uljes së dinjitetit personal dhe të keqsimin të shëndetit të të papunëve. Papunësia shoqërohet me uljen e vetvlerësimit, duke u shkaktuar dhimbje atyre që vuajnë për një kohë të gjatë prej saj. Papunësia e zgjatur e detyron individin që të tërheqet nga pjesëmarrja në mënyrë aktive në jetën shoqërore dhe politike të vendit, i këput ose i dobëson lidhjet e tij shoqërore. Shpesh papunësia bëhet shkak për gjendje depresive e sëmundje të tjera nervore, si dhe për një varg sëmundjesh të zemrës, etj.

## Matja e papunësisë

Dy karakteristikat kryesore të një recesioni ekonomik janë rënja në GDP dhe rritja e papunësisë. Ndryshimet në prodhimin maten nëpërmjet logaritjes së GDP, kurse ndryshimet në papunësi maten nëpërmjet llogaritjes së normës së papunësisë.

Të dhënat statistikore për llogaritjen e normës së papunësisë mund të merren në rrugë të ndryshme. Si burime kryesore statistikore mund të shërbejnë vrojtimitet statistikore, regjistratorët e Zyra të Punës ose regjistrat e sigurimeve për papunësinë. Shpesh herë, vlersimet zyrtare mbi papunësinë mbështeten në mënyrë krahasuese në të dhënat e më shumë se një burimi. Megjithatë, vende të ndryshme mund të mbështetën në burime të ndryshme, gjë që e vështirson, në një farë shkalle, krahasimin e treguesve përkatës midis tyre.

Në një kohë të dhënë, një individ mund të jetë i zënë me punë, i papunë ose jashtë forcës puntore.

**I zënë me punë** (i punësuar) konsiderohet ai person që kryen një punë të pagushme, qoftë edhe kur mungon përkohësisht në punë për shkak se është i sëmurë, me pushime ose në grevë.

**Të papunë** konsiderohen ata persona që nuk janë në punë por kërkojnë punë në mënyrë aktive, ose që presin të rikthehen në punë. Në një përkufizim më të plotë, një person është i papunë në qoftëse nuk punonë dhe **a)** ka bërë përpjekje specifike për të gjetur një punë gjatë katër javëve të fundit, **b)** është pushuar nga- -puna dhe pret që të thirret përsëri në këtë punë, **c)** është duke pritur të njoftohet për një punë të re muajin e ardhshëm.

Të punësuarit plus të papunët përbëjnë - **Forcën puntore**.

Të gjithë të tjerët që janë në moshë pune por nuk janë të zënë me punë, nuk përfshihen në forcën puntore ose në të papunët, ata konsiderohen thjesht jashtë forcës puntore. Ky grup përbëhet nga

pensionistët, studentët, nxënësve në moshe pune, ata largohen nga tregu i punës për të rritur, fëmijët si dhe personat që nuk kërkojnë punë për arsye të ndryshme.

Duke ditur numrin e të pa punëve dhe numrin e forcës punëtore, mund të llogarisim normën e papunësisë:

Norma e papunësisë(%)=

Në tabelë kemi paraqitur një shembull konvencional të llogaritjes së treguesve të mësipërm të tregut të punës.

---


1.Popullsia totale (në milion	258,4
Minus individet nën moshën 16 vjeç dhe të institucionalizuar	58
Minus individet që nuk përfshin në forcën punëtore	63
2. Baraz:Forca punëtore (në milionë)	117,4
Minus forca ushtarake	2
3. Baraz: forca puntore e civile ( në milionë)	115,4
a) Të punësuar	107
b) të papunë	8.4
4. Norma e papunësisë (në %) =	8.4: 115=7.3%

---

Shpesh herë treguesit e papunësisë përjashtojnë ata individë që janë të papunë por kanë humbur shpresën për të gjetur punë dhe për këtë arsye kanë hequr dorë nga kërkimi aktiv për një vend pune. Këta quhen të papunë të dëshpëruar (ose të dekurajuar). Sidoqoftë, kur heqin dorë nga kërkimi i një vendi pune, ata duhet të përjashtohen edhe nga kategoria e forcës punëtore.

Në një periudhë reçesioni ka një rritje në numrin e individëve që nuk mund gjejnë punë me kohë të plotë. Ata janë të detyruar , jashtë dëshirës së tyre , që të pranojnë një punë me kohë të pjesshme. Një punësim i tillë i pjesshëm shpesh nuk përfshihet në statistikat e papunësisë.

## II. Interpretimi ekonomik i papunësisë dhe llojet e saj



Autorë të shkollave të ndryshme ekonomike japin klasifikime të ndryshme të formave të papunësisë. Nevoja e përcaktimit të formave të papunësisë ka të bëjë me faktin se për reduktimin e formave të ndryshme të papunësisë përdoren politika ekonomike të ndryshme. T'i analizojmë disa prej tyre.

### **1. Papunësia e fërkimit (friksionale)**

Kjo lloj papunësie shfaqet sepse ekziston një lëvizshmëri e përhershme e njerzëve midis vendeve të ndryshme të punës dhe të rajoneve. Edhe kur ekonomia është në kushtet punëzënies së plotë, do të ketë gjithmonë një fluktacion të njerzëve që kërkojnë punë kur diplomohen pas përfundimit të shkollës, ose që lëvizin në rajone apo qytete të ndryshme. Gjithashtu, gratë rikthehen në tregun e punës pas lindjes së fëmijës. Meqëse me këtë rastë punëtorët e papunë lëvizin midis vendeve të ndryshme të punës ose kërkojnë punë më të mirë (dhe për ta realizuar këtë duhet njëfar kohe), thuhet se ata janë të pa punë vullnetarë.

Kjo lloj papunësie është e pashmangshme dhe ekonomikisht e justifikueshme, mbasi çon në shpërndarjen dhe rishpërndarjen efektive të burimeve të punës.

### **2. Papunësia strukturore**

Kjo lloj papunësie ndodh kur ekziston një mospërputhje strukturore afatëgjatë midis kërkesës dhe ofertës për punë. Kjo mospërputhje mund të ndodhë sepse kërkesa për një lloj pune rritet ndërkohë që kërkesa për një lloj tjetër pune bie dhe oferta nuk i përshtatet shpejt këti ndryshimi.

Këto ndryshime në kërkesën dhe në ofertën për punë ndodhin sidomos për shkak të ndryshimeve fundamentale në degët bazë të ekonomisë. Një dukuri e tillë shoqërohet me rënien e degëve kryesore dhe për pasojë, edhe me vjetërsimin e aftësive apo mjeshtërive të lidhura me to. Problemi bëhet veçanarisht serioz në rajonet ku kanë qenë të koncentruara këto degë. Koncentrimi i degeve depresive të ekonomisë ja lë vendin koncentrimit të papunësisë në këto rajone.

Imobiliteti profesional (mungesa e gadishmërisë dhe vështirësitë për të braktisur profesionet e vjetra dhe për përvetsimin e profesioneve të reja) dhe imobiliteti gjeografik (mungesa e gadishmërisë dhe vështirësitë lidhur me largimin nga rajonet depresive për arsye sociale, ekonomike, etj), kontribuojnë në ruajtjen e niveleve të larta të papunësisë në rajonet depresive për një kohë të gjatë.

Vetë ndryshimet strukturore në degët e ekonomisë mund të ndodhin për shkaqe të ndryshme, për shembull, zhvillimi dhe aplikimi i teknologjive të reja, ndryshimet afatgjata në preferencat e konsumatorëve, etj.

## 9.1. Papunësia ciklike

Kjo lloj papunësie rezulton nga pamjaftueshmëria e përgjithshme në kërkesën agregate. Dihet se kërkesa për punë është një kërkesë e prejardhur. Kjo do të thotë se një lloj pune kërkohet sepse kërkohet produkti që ajo prodhon.

Në kushtete kur ekonomia ndodhet në fazën e rënies ekonomike, ndodh rënia e kërkesës për të mira dhe shërbime. Rjedhimisht, prodhimi do të reduktohet dhe si pasojë firmat do të reduktohet dhe si pasojë firmat do të kërkojnë më pak punë.

## 9.2. Papunësia sezonale

Papunësia sezonale lidhet me karakterin stinor të prodhimit. Kjo formë papunësisë shfaqet në degët e industrisë së ndërtimit, në bujqësi, në shërbime, në turizëm, etj., sepse në këto degë karakteri stinor i prodhimit dhe kushtet e motit parapërcaktojnë edhe kërkesën për punë.

### Cilat janë shkaqet e papunësisë?

Për asnjë çështje tjetër të teorisë ekonomike ekonomistët nuk i kundërvihen kaq shumë njëri tjetrit se sa për qështjen lidhur me shkaqet e papunësisë. Në tregun e mallrave një ekuilibër i prishur rivendoset, ndër të tjera, duke ngritur apo duke ulur çmimin. Por në tregun e punës nuk mund të ndodhë e njëjta gjë. Për shembull, spitalet kërkojnë infermerë ose ajo është shumë e pakët. Ndërkohë mijëra puntorë çeliku dëshirojnë të punojnë me pagën ekzistuese të tregut, por nuk gjejnë punë mbasi nuk ka kërkesa nga firmat që të punësojnë punëtorë çeliku. Pse ndodh kështu?

Për ti dhënë përgjigje kësaj pyetjeje duhet të mbajmë parasysh bazat mikroekonomike të papunësisë. Përgjithësisht pranohet se në sjelljen e faktorit punë një rol përcaktues luajnë pagat. Por pikërisht këtu fillon dallimi midis ekonomistëve lidhur me shpjegimin e papunësisë dhe natyrën e saj.

Sipas njërës pikëpamje, shkak i papunësisë duhet kërkuar në ngurtësinë e pagave. Pagat jo fleksibile i japin papunësisë karakter të detyruar. Sipas pikëpamjes tjetër, pagat janë fleksibile, jo të ngurtësura dhe në këto kushte papunësia nuk mund të konsiderohet e detyruar, ajo është papunësi e vullnetshme.

**Papunësia e vullnetshme.** Arsyet e mungesës së dëshirës për të punuar në një nivel të dhënë të pagës orare të tregut mund të jenë të ndryshme.

Ato mund të lidhen me preferencat që kanë individët për kohë të lirë dhe për punë, për të ndjekur shkollën, për tu kujdesur për fëmijët, etj. Por është e rëndësishme të theksojmë se papunësia e

vullnetshme mund të jetë ekonomikisht efiçente. Pra , ekonomia mund të punojë me efiçencë më të lartë pavarësisht nga fakti se ajo gjeneron një numër të caktuar të papunësh.

Si përfundim, mund themi se, në një treg pune të karakterizuar nga një pagë plotësisht fleksibile, nuk mund të ketë papunësi të detyruar. Edhe në këtë treg, ashtu si çmimet në tregun e të mirave dhe të shëbimeve, çmimi i punës (paga) luhet lart e poshtë, deri sa tregu të pastrohet (të rikthehet në ekujlibër).

**Papunësia e detyruar.** Kejnsi dhe shumë ekonomistë të tjerë theksojnë se papunësia e lartë që ndodh në fazën e recesionit nuk reflekton vendimet e vullnetshme të individëve për të mos punuar në një nivel të dhënë të pagës orare të tregut. Sipas mendimit të tyre, papunësia ciklike ndodh sepse pagat janë jofleksibile. Pagat jo fleksibile nuk janë në gjendje të rregullojnë me shpejtësi mungesën ose tepricën e forcës punëtore në tregun e punës.

Kur ka një tepricë punëtorësh firmat do të kenë kërkesa më rigorozë për kualifikim dhe aftësim, dhe do të zgjedhin midis tyre punëtorët më të kualifikuar dhe më me eksperiencë.

### 9.3.Burimet e inflacionit

Ekzistojnë pikpamje tëndryshme lidhur me shkaqete ,burimet e inflacionit .Sido qoftë mbizotëron pikpamja se inflacioni tentontë jetë inercial domëthënë me norma te pandryshuara përderisa në ekonomi nuk kanë ndodhu ndryshime të rëndësishme në anën e ofertës dhe të kërkesës.Në këtë mënyrë ,në funksion të analizës së burimeve të inflacionit duhet të dallojm inflacionin inercial inflacionin nga kerkesa dhe aj nga oferta

Inflacioni inercial ,quhet ndryshe inflacion I parashikushëm ose I pritshëm ,perderisa norma e inflacionit është e qendërushme (inerciale),per sa kohë nukë ndodhin ndryshime në anën e kërkesës dhe të ofertës .Shpesh në mënyrë figurative inflacioni inercial krahasohet me një qen të vjetër që fle. Në qoftë se qeni goditet në këmbë ,qeni do të lëvizë pak por pastaj do të shtrihet në vendin ku ishte para goditjes .Vetëm në qoftë se goditet fortë sidomos në kokë do të kërcej përpyjet ,Në ekonomin e vendeve të zhvilluara kapitaliste ,inflacioni ka shprehur qartë një prirje inerciale ,duke patur një normë pak a shumë të qendrushme ,

Por inflacioni jo gjithmonë qëndëron në një normë konstante ,sepse ekonomia nuk është “si një qen I vjetër që fle”për një kohë të gjatë Ajo herë pasë here pëson goditje të ndryshme që mund të vijnë si pasojë e një kërkesë të lartë apo të ulët ,të të korrave jot ë mira në bujqësi ,luhatjeve në kurset e këmbimit valuator ,ndryshimeve në produktivitetin e punës dhe ngjarjev të tjera ekonomike .Kur ndodhin fenomene të tilla në ekonomi pritjet e agjetëve ekonomik mund të ndryshojnë ,pra ndryshon edhe norma e parashikuar e inflacionot .Në varësi nga fakti nëse



goditja ekonomike lidhet me kërkesën apo ofertën agregate ,inflacioni rezultues ,quhet inflacion nga kërkesa dhe inflacion nga oferta

## 9.4. POLITIKA FISKALE

Politika Fiskale ka të bëjë me përdorimin e shpenzimeve qeveritare dhe politikën e taksave për të arritur qëllimet të caktara ekonomike dhe sociale,

Këto qëllime ndahen në tre grupe:Alokative,shpërndarëse dhe stabilizuese.

**Qëllimi alokativ-** ka të bëjë me ndikimin e politikave buxhetore të qeverisë në alokimin e resurseve të shoqërisë.

**Qëllime shpërndarëse-**kanë të bëjnë me ndikimin e politikave buxhetore më shpendarejen e të ardhurave të shoqërisë,politika qeveritare kanë ndikime të ndryshme mbi grupe të ndryshme të popullsisë.

**Qëllimet stabilizuese-**kanë të bëjnë me ndikimin e qeverisë mbi inflacionin,papunësi dhe rritjen ekonomike .

Politika fiskale ka të bëjë me politikën e shpenzimeve qeveritare për blerje mallrash e shërbimesh e për kryerjen e pagave të transferueshme nga njëra anë,dhe me politikën e sigurimit të të ardhurave e para së gjithash të taksave nga ana tjetër.


## 9.5. BUXHETI QEVERTAR DHE POLITIKA FISKALE

Shpenzimet dhe të ardhurat e parashikuara nga qeveria për një periudhë njëvjeqare,pasqyrohet në buxhetin qeveritar.

Buxheti është i për dhe bërë nga pjesë jot e domosdoshmërisht të barabarta: Shpenzime dhe të ardhurat, ai shërbene për të regjistruar dhe kontrulluar si kryerjen e shpenzimeve ashtu edhe realizimin e të ardhurave të planifikuara. Në buxhetin qeveritar si shpenzime ashtu edhe të ardhurat paraqiten të detajuara ,përkatsishtë sipas drejtimeve të kryera së shpenzimeve (arësim,mirëqenie, mbrojtje etj) Kurse burime të të ardhurave (taksa mbi të ardhurat individuale,taksa mbi sigurimet sociale, taksat mbi të ardhurat e korporates etj,)

Buxheti qeveritar mund të jetë me tepriçë positive (sufiqitar)me tepriçë negative (defiqitar)ose i balancuar, në qoftë se të ardhurat i tejkalojë shpenzimet buxheti është sufiqitar ,kurse shpenzimet tejkalojnë të ardhurat është deficit ,kur të ardhurat janë të barabarta me shpenzime kemi buxhet të balancuar.

Për të mbuluar defiqitin e buxhetit në rastet kur buxheti është defiqitar qeveritar mund të ndjekë dy rrugë:



- a) Të shtypë ( emetoj )paranë
- b) Të marrë hua nga publiku (ose nga vende të tjera)

Këto janë pikërishtë huatë e akumuluar të qeverisë që e përbëjnë borxhin qeveritar, domëthënë ndaj individëve ,bankave, firmave, të huaja etj.

Synimet makroekonomike qeveritare ndyshone ne progrmte e saj mbi shpenzimet apo të ardhurat .Qeveria ka si synim të rrisë kërkesën ose ofertën agregat,ajo do të ndiqte një politikë fiskale zgjeruese ,Në të kundertë në qoftë se synimi është i ulte kërkesen edhe ofertën agregate Kemi të bëjme me politiken fiskale kufizuse.

Ajo politike fiskale që relizohte nëpër veprimet aktive të qeverisë quhet **Politike fiskale aktive** e cila mund te jetë zgjeruse ose kufizuse, kurse një veprim automatic apo spontan i sistemuar fiscal në përgjigje te ndryshme ekonomike qe është rezultat i vendimeve të mëparshem të qeverisë quhen **Politike fiskale automatike**,

Politika fiskale automatike mund të jëtë zgjeruese ose kufizuse


Dallojmë katër lloje te politikash fiskale:

- 1.Zgjeruese aktive
2. Kufizuse aktivepo
- 3.Zgjeruse automatike
- 4.Kufizuse automatike.

Nepër mes nje table 23.1 paraqiten katër llojet e politikës fiskale dhe tregohet se një politikë fiskale zgjeruse active përfshinë veprime të paramenduar të qeverisë që rrisin shpenzimet qeveritare ,ulin takasat ose të dyjat se bashku,kurse një politikë fiskale kufizuse active ka të bëjë me veprime të qeverisë që ulin shpenzimet qeveritare .rrisin taksat ose të dyjat se bashku ,po ashtu tabela 23.1 tregon gjithashtu se kompresioani për papunësinë dhe asistenca sociale janë shëmbuj të politikave fiskale zgjeruse dhe kofizuse. P sh ne qofte se ekonoomia është në rënie ,shumë njerëz do të mbeten pa punë dhe do të dhe do të jetë kërkues të ndihmave për papunësinë dhe asistencë sociale.

Kompenzimi per asisitenc sociale zbusin kontraditat e ciklit te biznesit duke shmangur rënie e shpenzimeve te konsumit ,Pra gjatë një rënie ekonomike,kompresimi për papunësinë dhe asistencen sociale e rënies sociale janë masa fiskale zgjeruse automatike që zbusin intensitetin e rënies .

Tabela 23.1 Llojet e politikës fiskale



	Zgjeruese	Kufizuse
Aktive qeveritar	-Rritja e shpenzimeve Qeveritare -Ulje e taksave -ose të dyjat (1)	-Ulje e shpenzimeve -Rritje e taksave -ose te dyja (2)
Automatik	Kompensim për papunësinë Asistenca sociale (3)	Kompensimi për papunësinë Asistenca sociale (4)

Stabilizatorët kryesor automatikë të ciklit të biznesit që veprojnë në kuadrin e sistemit fiscal janë kuadrin e sistemit fiscal janë:

**a)Ndryshimet automatike të të ardhurave nga taksat-në** vendet perendimore zbatohet sot shkallëtë të gjerë të taksat progresive mbi te ardhurat personale apo të korporatave,karakteristika e tyre është se me rritje të ardhurave rriten edhe norma e taksave,në këto kushte sistemi fiskal i përgjigjet në mënyre automatike dhe në drejtimin e duhur çdo ndryshim i papritur ne ekonomi.Ne qofte se te prodhimi bie atëher të ardhurat nga taksat bien automatikisht duke i rritur relativisht te ardhurat e disponushme e për pasoja edhe shpenzimet për konsum apo investime,kures ne periudhen inflacioniste do të rriten të ardhurat nga taksat do te ulen të ardhurat personale duke ndikuar në pakësimin e konsumit e për pasojë edhe të kërkesës aggregate si dhe duke ulur spiralen page-çmim.

**b) Pagesat për papunësinë,fondet e bamirësisë dhe pagesat e tjera të transferushme-ne** situata depressive kur dhe papunësia është e lartë pagest për papunësinë rriten,kurse në situta inflosianiste ato ulen.Pra fondet për papunësinë rriten dhe ulen në drejtimë të kundërt me lëvizjen ciklike,dkue sjellë efekte stabilizuse,ku e njeja gje mund të thuhet edhe për programet e ndyshem të ndihmës ushqimore të ndihmës mjeksore etj,gjith ashtu stabilzatore automatikë vuajnë nga dy mangësi:

1.Efektet negative në ofertën aggregate

2.Problemi i pengesës fiskale

**Efekte negative në ofertën agregate**-normat e larta te taksave mund te frenojmë ofertën agregate dhe të deklarojnë iniciativën.Një rritje me normen marxhinale të taksës mbi të ardhura është njëjtë me një rritje në kosto marxhinale të punës.

Në masën që taksat progresive mbi të ardhurat frenojnë rritjenë e kërkesën aggregate sa më e vogel të jetë rritja në oferte aggregate aq më e madhe do të ishte nora e inflacionit.Pagat e larta për papunësinë mund të rrisin qëndrueshmërinë e papunësisë sepse mund te nxisin njerëzit që të presin për të gjetur punën e “përshtatshme” në vend që të ndikojë në zvogëlimin e efektit përfitues për të papunësuarit nga stabilizuesi automatikë ,megjithatënë masën që kijo papunësi është më shumë vullnetare se sa jo vullnetare mund të thuhet se problemi i papunësisë është më i qetë,

**Problemi i pengesës fiskale**-Stabilizusit automatikë ndihmojnë në zbutjen e ulje-ngritjeve të ardhurave kombetare ,në qofte se ekonomia fillon të rigjallërohet ,stabilizusit automatikë do te veprojnë si një pengesë për zgjerim, duke ule madhësinë e multiplikatorit stabilizuesit automatikë zvoglojnë masën e gjallërimit të ekonomisë,gjithëashtu ato veprojnë si një pengese në politikën e kujdesshme fiskal të qeverise ;sa më të fuqishme të jenë stabilizuesit automatik aq më i madh duhet të jetë ndryshimi në shpenzime qeveritar apo në taksat,në mënyrë që të arrihet ndryshimi I dhënë në të ardhurat kombëtare,Pra për të realizuar objektivat e politikës fiskale qeverai e ka të nevojshme të ndërhyrjë drejtëpërdrejt me instrumente të kësaj politike.Instrumentat kryesor (stabilizatorët aktiv)Të politikës fiskale aktive janë:

**Projektet e investimeve publike-të** tilla si projekte e elektrifikimit të furinizimit me uijë etj,sot projektetet e tilla relativisht afatgjata ,pra që kanë nevojë për një kohë relativisht të gjatë që tëvihet në jetë perdoren rralë ,efektet e tyre kundër ciklike mund të jenë negative pra atom mund të fillojnë kur faza përkatase e ciklit të biznesit të këtë kaluar.

**Projektet publike të punësimit** – ndryshe nga projektet publike të investimeve që kërkojnë shumë capital dhe kohë për tu realizuar,projektet publike te punësimit synojnë zënien me punë të punëtorëve në periudha deri në peridha deri në një vit,

Këto projekte përfaqësojnë një mjet stabilizimi që është perdorur më shpesh kohën e fundit ,ku ndaj këtë mjeti kritik që lidhen me inficiencen e tyre dhe më faktin që ato nuk ofrojnë punëzimë serioze të të papuneve.

**Ndryshimi i normave të taksave**-ndryshimi i normave të taksave në drejtimin e duhur përdoret për të stimuluar apo frenuar zhvillimin e ekonomisë,ky mjete mund te përdoret me sukses vetëm në qoftë se do te arrihet një ndryshim i shpejtë dhe i përkohshem i taksave sepse në të mund të kalonte faza përkatse e ciklit dhe ndryshimi i taksave në vend që të sillte dobi do të sillte dëm,nga një anë është e vështirë të arrihet një ndryshim i shpejtë dhe i përkohshëm i taksave,kurse nga ana tjetër njerëzit duke qenë të ndërgjëgjshem për karkteristikat e përkoshëm të ndryshimit të taksave,nund te ndryshojë në mënyrë të mjaftushme sjelljen e tyre duke e kushtëzuar kështu efektet të kufizuara kundër ciklike të kësaj politike fiskale.

Zbatimi i një politike të caktuar fiskale do të këtë ndikimin e vet në buxhetin e qeveisë,përkatsisht në zërat e shpenzimeve apo të të ardhurave dhe për rrjedhojë edhe në gjendje e buxhetit,si buxhetit sufiçitar,defiçitar apo i balancuar.

Gjate zbatimit të politikave fiskale,qeveria duhet të kujdeset për të mbajtur buxhetin gjithmonë të balancuar apo mund të lejohet sufiçit ose defiçite për një kohë relativisht të gjatë

Në vazhdim do ti japim përgjigje kësaj pyjete ,por më pare evidentojnëdy moment të rëndesishme për analizën e mëtejshme:

Së pari:tradicionalisht deri 50-60 vjet më pare,financat publike janë mbështetur në tre parime bazë të përcaktuar që në kohën e Adam Smithit.

- Financat publike janë thjesht një aplikim i financave të familjes,ne qofte se një familje shpenzon më shumë se sa të ardhurat e saj mujore,ajo shkon në falimentim dhe varfëri,e njëjta gjë është e vërtetë edhe për qeverinë
- Buxheti duhet të jetë i balancuar çdo vit dhe i kufizuar duke zbatuar kritere strict për shpenzimet
- Buxheti qeveritar është një barrë për brezat e ardhshëm  
Shumë specialist të kësaj fushe mbrojnë idene se nuk është e domosdoshme që qeveria të ndjekë politikën e balancimit të buxhetit por mund të zbatojë edhe një buxhet defiqitar. Se dyti financat publike modern bëjnë dallimin midis defiqiteve struktureore dhe defiqiteve ciklike duke perdor vemendje tek defiqitet struktureore Deficit strukturor dhe ai ciklik janë pjesë përbërse e defiqitet aktual,

Defiqiti aktual=defiqit strukturor+deficit ciklik

**Defiqiti aktual-** përfaqëson defiqitin faktik në një periudhë të dhënë

**Defiqiti strukturor-** përfaqëson atë pjesë të defiqitetit faktik që kushtëzohet nga politika fiskale active (për shembull ndryshimi i normave të taksave i shpenzimeve për mbrojtjen e arsimin etj).

**Defiqiti ciklik-**përfaqëson atë pjesë të defiqitetit faktik qe përcakton në mënyrë automatike nga gjendja e ciklit të biznesit .

Per te sqaruar konceptet e mësipërme është e nevojshmr të dime se çfarë përfaqëson buxheti aktual,buxheti strukturordhe buxhetit ciklik.

Buxheti aktual pasqyron shpenzimet të ardhurat dhe defiqitin faktik në një periudhë të dhënë.

**Buxheti strukturor** pasqyron shpenzimet të ardhurave dhe defiqitetit që do të eksistonin ,në qoftë se ekonomia do të funksiononte në kushtet e prodhimit potencial.

**Buxheti ciklik** pasqyron efektet e ciklit të biznesit në buxhet ,pra pasqyron ndryshimet në shpenzime të ardhurat dhe defiqitetet si rezultat i mosfunksjonimit te ekonomisë në kushtet e prodhimit potencial pra si rezultat i ndodhjes së saj në shtate depresioni ose burimi ekonomik.

**Buxheti aktual=buxhetin strukturor+buxheti ciklik**

Në praktik dallimi midis buxhetit strukturor dhe atij ciklik bëhet nëpërmjet dallimit të ndryshimit që ekziston midis stabilizatorëve që veprojnë aktive apo automatikë.Ndërsa buxheti strukturor lidhet me stabilizatorët aktive,buxheti ciklik lidhet me stabilizatorët automatikë.

Politika fiskale aktive e qeverisë ndikon nëpëmjet efekteve të saj në përmasat e prodhimit dhe në buxhetin ciklik e për rrjedhojë edhe në defiqitin ciklik,në qoftë se

qeveria vendosa pakësimin e shpenzimeve ushtarake me një shumë të caktuarë kjo do të pakësonte defiçitin struktural me të njëjtën shumë,  
Efekti neto i politikës fiskale aktive ndyshon në të njëjtin drejtim si defiët strukturor ashtu edhe atë aktual,por për të shpejtuar ndikimin e politikës fiskale në ekonomi duhet te mbajmë parasysh defiçitin strukturor dhe jo atë,ky i fundit ndikon edhe nga ndryshimet e parashikuara ciklike të ekonomis .Për kete arsye buxheti strukturor përmbën një nga instrumentet kryesore të analizës makroekonomike ,ajo na lejon të veqojmë efektet e masave politike nga efektet e ciklit te biznesit duke na dhënë mundësi që të parashikojnë ndikimin e politikës fiskale në ekonomia.

## 9.6. Ndërveprimet e politikave monetare dhe fiskale

Politikat fiskale dhe ato monetare mund të përdoren për të stimuluar ekonominë dhe për të ndihmuar në shërimin e plagëve të saj ,kur inflacioni bëhet kërcenus,këto politka ndihmojnë në uljen e flakëve inflacioniste.

Si politikat fiskale ashtu edhe ato monetare lidhen me menagjimin e kërkesës aggregate,pra nevoja e përdorimit të këtyre politikave lind kur kërkesa aggregate është në nivel të papërshtatshem domethen kur ajo është më e vogel ose me e madhe se produkti potencial,të dyja këto politika mund të pëdoren të kombinuara.

Nevoja e kombinimit te tyre mund të lindë kur kërkohet jo vetëm ndryshimi i nivelit të kërkesës agregate (pra GDP)por edhe i përbërjes së saj(GDP)duek ndryshuar peshen specifike të komponentve përbërës.

Si duhet te veproji qeveria ne këto raste:

Se pari ajo drejtëpërsëdrejti duhet të rrisë shpenzimet qeveritare pa ndryshuar nivelin e taksave

Se dyti për të mos ndryshuar nivelin total të prodhimit ,qeveritar në të njejeten kohë duhet të zbatojë një politikë të shtrëngumonetare që çon në rritje e normave të interest duke dekurajuar investimet dhe shpenzimet e tjera që janë të ndjeshme ndaj normës së interest (eksportet neto,ndërtimet e banesave etj)Në praktikë nuk është i lehtë përdorimi i kombinuar i këtyre politikave .Politika fiskale me pritje defiçitare kerkon në një faze mënyra zbatimin e një politike të shtrenguar monetare duke kushtëzuar në këtë rritjen e vazhdushme të normave të interest.

Politika monetra mund te përdoret te kombinuara me poltiiken fiskale edhe për të reduktuar apo eliminuar fenomenin e **ngushtimit të shpenzimeve private(Croëding out)** kur rriten shpenzimet qeveritare ,pra fenomeni “croëding out” ka të bëjë me pakësimin e shpenzimeve qeveritare ose të nevojave për financimin e defiçitit.

Cili është mekanizimi i “Crowding out” Supuzojmëse qeveria fillon zbatimin e një projekti për ndertim rrugësh duke rrit shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime,

Rritja e shpenzimeve qeveritare do të thotë rritje e kërkesave për para,por rritja e kërkeses për paran është kur oferta monetare supozohet e pandryshshme çon në rritje normën e interest , ne e dim serritja e norma e interest dekurajon investimet si dhe shpenzimet e tjara të ndjeshme ndaj norës së interest.Për rrjedhojë do të ulej efektiviteti i politikës fiskale si rezultat i ndikimit të tregut monetare

Theksojmë se “crowding out” lidhet me politikën fiskale aktive pra me efektet e defiçitit strukturor dhe jo me atë ciklik,në qoftë se deficit ka natyre ciklike logjika e “crowding out” nuk ekziston .ndodh keshu sepse depresioni shkakton rënie më kërkesë për para e për pasojë çon në uljen e normës së interest,që ka efekte nxitëse tek investimet


Shumica e ekonomistëve bien dakort që deficit strukturor ndikonë ne reduktimin e investimeve ,diskutimet dhe kundërshtimet midis tyre lidhen me faktin sesa është masa e këtij reduktimi.Kur politika fiskale stimulon ekonominë nëpërmjet rritjes së shpenzimeve qeveritare,kërkesa për para rritet dhe kur oferta monetare është fikse noram e interest rritet ,Rritja e norms së intersit do të vazhdojë deri në atë masë sa rënia e investimeve të arrijë në masën e plotë të rritjes së shpenzimeve qeveritare

Pra sipas pikëpamje klasike-monetariste rënia e investimeve që është 100% e barabart me rritjen e shpenzimeve qeveritare do të eliminojë plotësisht efektin e politikës fiskale ,prarritjen e GDP për shkak të rritjes së shpenzimeve qeveritare,por shumë ekonomistë mendojnë se këndvështrimi klasik-monetarise është një rast ekstrem,një pjesë e tyre pohojnë se kur ekonomia është në pra kur ka burime të papërdorura ,deficit mund të kenë **ndikim inkurajus** mbi investimet

## 10. Pasojat ekonomike të borxhit qeveritar

Huatë e akumuluar nga qeveria për të mbuluar defiçitin buxhetor,përbëjnë **borxhin qeveritar ose publik** ,Pjesa më e madhe e këtij borxhi është në formën e letrave me vlere që sjellin interes si obligacionet etj.

Ndryshimi i borxhit qeveritar gjatë një periudhe të dhënë kohe(1) është i barabartë me defiçitin buxhetor.



Në vitin 1988 borxhi public i SHBA ishte 1790 miliardë dollarë ose 37% e GDP vjetore. Vatem pagesat e interes për borxhet përfaqësonin 3.2% të GDP.

Po kështu më 1818 Anglia kishte një borxh publik që vlërsohej sa dyfishi i fuqisë së saj

Në të kundërtën në vitet 70 megjithse me një borxh publik modest ekonomika Angleze ishte zhytur në stanchion. Pra nuk ka arsye për paragjykuar çdo borxh qeveritar si dukuri të dobësië apo si faktor frenimi për ekonominë dhe popullsinë e vendit ,Megjithatë borxhi qeveritar përfaqëson një barrë për ekonominë dhe popullsinë e vendit që e ka këtë borxh, borxhi shoqërohet me një varg problemesh si :

- 1 .Nevojat për ti shërbyer borxhit të jashtëm;
2. humbja e efijences për shkak të rritjes së taksave në mënyre që të paguhet interes dhe vetë kështet e borxhit;
3. ”zhvendosja” e kapitalit ku njëzrit mbajnë një borxh public në vend të akteve të bazuara në capital;

Le te sqarojme më radhë problemet e mësipërme

Para se gjithash duhet të bëjmë dallimin midis borxhit të brendshëm dhe borxhit të jashtëm

**Borxhi i brendshëm** është që një vend i detyrohet qytetarve të vet, edhe relativisht e përhapur pikpamja e borxhi i brendshëm nuk përbën ndonjë barrë sepse në këtë rast “i jemi borxh vetvetes ndërsa

**Borxhi I jashtëm** përfaqëson borxhin që një vend u detyrohet të huaja dhe është një zbritje neto nga mallrat shërbimet në dispozicion të njëzve të vendit borxhi .

Vende të tilla si Polonia ,Brazili dhe Meksika ishin të detyruar gjatë viteve 80 të siguronin balance tregtare positive për ti shërbyer borxhit të jashtëm .Kështu për shembull Brazili apo Meksika në mesin e viteve 80 duhet të paguhet 1/4ose1/3 e të ardhurave nga eksporti për ti shërbyer borxhi borxhi të jashtëm duke ulur në këtë mënyrë konsumuin e mundëshem Brenda vendit.

### 10.1.Humbja e efijencës nga rritja e taksave

Një borxh i mbrenshëm kërkon pagimin e interesave ndaj mbajtësve të obligacioneve dhe për këtë qëllim rriten taksat. Madje, disa njerëz duhet të paguajnë taksa të njëjta me shumën që ata marrin si interes. Përdorimi i

taksave për pagimin e interesave, ka efekte negative në nxitjen e njerëzve për të punuar dhe kursyer, gjë që shoqërohet me uljen e efijences.



## 10.2.Zhvendosja e kapitalit

Ndoshta pasoja me serioze e një deficit të madh qeveritar është “zhvendosje” e kapitalit nga stoku i pasurisë së një vendi. Njerëzit i mbajnë pasuritë e tyre në forma të ndryshme të cilat mund t’i ndajmë në dy grupe: (1) letra me vlerë të qeverisë (bono thesari, obligacione), (b) aktive, që në fund të fundit paraqesin pronësi mbi kapitalin privat, tokën, etj.

Në qoftë se rriten zotërimet e obligacioneve nga njerëzit, duke e marrë të pandryshuar shumën e pasurisë së tyre, kuptohet që do të zvogëlohen aktivet që përfaqësojnë zotërim capital. Pra, kapitali. Privat do të zëvendësohet, do të “zhvendoset” nga borxhi qeveritar.

## 11.MARRËDHËNJET EKONOMIKE NDËRKOMBËTARE

Sistemi ekonomik i mbështetur në tregun presupozon lidhje të ngushta midis ekonomive të vendeve të ndryshme, lidhje që vijnë duke u thelluar vazhdimisht. Këto lidhje realizohen nëpërmjet dy kanaleve kryesore, tregtare dhe financiare. Analiza e marrëdhënieve që shprehin këto lidhje përbën një fushë të veçantë të teorisë ekonomike, që quhet Ekonomiksi ndërkombëtar.

Disa nga elementet dhe nocionet kryesore që studjon kjo shkencë do të mundohemi t’i paraqesim në vija të përgjithëshme nëpërmjet analizës së tregëtisë ndërkombëtare, bilancit të pagesave dhe tregut valuator.

### 10.1.Tregtia ndërkombëtare, faktorët që e përcaktojnë dhe ekuilibri në tregun ndërkombëtar

Ekonomitë e vendeve që lidhen me njëra-tjetrën nëpërmjet eksportit dhe importit, quhen ekonomi të hapura. Shkalla e hapjes së një ekonomie shprehet nëpërmjet raportit të vëllimit të eksport-importit ndaj GDP. Sa më i madh të jetë ky raport, aq më e hapur është ekonomia e një vendi. Zakonisht vendet më të zhvilluara kanë shkall më të lartë të hapjes së ekonomisë. Për të shpjeguar pse ndodh kështu, para së gjithash, duhet analizuar pse egziston tregtia ndërkombëtare, pse vende të ndryshme importojnë dhe eksportojnë mallra dhe shërbime:

*Eksperti përfaqëson shitjen e mallrave dhe shërbimeve të një vendi në vende të tjera, kurse importi blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga vendet e tjera. Eksperti dhe importi i mallrave dhe shërbimeve është një domosdoshmëri që kushtëzohet nga një varg faktorësh:*

- **Kushtet e ndryshme të prodhimit**

Kushtet e prodhimit, ku përfshihen burimet natyrore, toka, kapitali, teknologjia, kushtet natyrore, janë të ndryshme në vende të ndryshme, prandaj edhe sasia, llojllojshmëria, cilësia e mallrave dhe e shërbimeve që prodhojnë vend të ndryshme nuk janë të njëjta. Për shembull, vendet me klimë të ngrohtë specializohen në prodhimin e frutave tropikale, sported që lidhen me detin, etj., kurse vendet me klimë të ftohtë specialohen në prodhimin e mishit të kafshëve që rriten në këtë klimë si dreri polar, peshku, etj. dhe në sportin e skive, etj.

- **Ekonomizimet e shkallës**

Në shumë firma dhe degë të ndryshme, me rritjen e madhësisë së tyre të prodhimit vihet re rënia e kostos për njësi. Këtë dukuri e kemi quajtur *ekonomizim të shkallës*. Parë në aspektin ndërkombëtar, ato vende të cilat kanë fituar një pozicion superior në prodhimin e një produkti të caktuar kanë avantazhin e ekonomizimeve të shkallës. Prandaj ato specializohen në prodhimin e këti produkti, duke e eksportuar në vende të ndryshme që nuk e kanë këtë pozicion dhe që do të duhej të zgjeronin shumë madhësinë e prodhimit për të përfituar nga ekonomizimet e shkallës, gjë që do të kërkonin investime të mëdha.

- **Ndryshimet në shijet**

Edhe në qoftë se kushtet e prodhimit do të ishin të njëjtë për çdo vend, përsëri do të ishte e leverdishme të eksportohej dhe të importohej, përderisa shijet ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Për shembull, supozojmë që Shqipëria dhe Greqia prodhojnë në të njëjeten sasi mish qengji dhe mish pule, por shqiptarët pëlqejnë më shumë pulat, kurse grekët pëlqejnë më shumë qingjat. Edhe në këtë rast është e qartë që do të rritet kënaqësia e shqiptarëve dhe e grekëve, që vjen nga konsumi i mishit, në qoftë se do të shkëmbehej një sasi mish qengji dhe mish pule midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Sidoqoftë, arsyeja kryesore që qëndron në themel të faktorëve të mësipërm, e që bën të domosdoshme tregtinë ndërkombëtare, është një nga parimet më themelore të ekonomisë, që njihet si **parimi I avantazhit krahasues**. Ky parim i rëndësishëm kushtëzon këmbimin e të mirave dhe shërbimeve midis individëve Brenda vendit dhe midis vendeve të ndryshme dhe buron nga ndarja shoqërore e punës, që çon në rritjen e rendimentit të saj. Thelbi i avantazhit krahasues qëndron në pohimin që çdo vend mund të përfitojë nga tregtia me vendet e tjera, edhe në qoftë se nuk gëzon asnjë avantazh absolute. Mjafton që çmimi relative (kostoja oportune) i mallit të eksportuar të jetë më I ulët se ai I mallit të importuar. *Avantazhi absolute shpreh aftësinë e një vendi për të prodhuar, me të njëjtat burime, një sasi më të madhe produkti se sa vendet e tjera*. Për shembull, Australia mund të ketë një avantazh absolute në prodhimin bujqësor në krahasim me Kinën, në kuptimin që për njësinë e punës prodhon më shumë produkte bujqësore se Kina. Le ta ilustrojmë këtë ide:

Tabela: Avantazhi absolute

Vendet	Grurë (1 kg)	Oriz (1 kg)
Australia	2 orë punë	4 orë punë
Kina	6 orë punë	8 orë pune

Siç shihet, Australia ka avantazh absolut ndaj Kinës, sepse për çdo njësi grurë apo oriz harxhon përkatësisht më pak punë.

Por kjo nuk do të thotë që për Australinë është më efektive që të prodhojë vetë gjithë sasinë e grurit dhe të orizit që i nevojite. Në pamjen e parë mund të duket paradoksale, por do të ishte më efektive për të dy vendet që ato të specializohen në prodhimin e produkteve ku kanë avantazh krahasues, pavarësisht nga avantazhi absolute. *Por ç'është avantazhi krahasues?*

**Avantazhi krahasues përfaqëson një ligj, sipas të cilit një vend mund të specializohet në prodhimin dhe eksportin e atyre mallrave që mund t'i prodhojë me kosto relativisht më të ulët dhe të importojë ato mallra që mund t'i prodhojë me kosto relativisht më të lartë.** Avantazhi krahasues llogaritet duke u mbështetur në koston oportune të secilit produkt. Në shembullin tonë, për Australinë, kosto oportune e një kg gruri është  $\frac{1}{2}$  kg oriz, sepse për të prodhuar një kg grurë më shumë, duhet të heqim dorë nga prodhimi i  $\frac{1}{2}$  kg oriz. (Për një kg grurë duhen 2 orë pune, pra aq sa duhen dhe për  $\frac{1}{2}$  kg oriz). Për Kinën, kostoja oportune e 1 kg gruri është e barabartë me  $\frac{3}{4}$  kg oriz (sepse për një kg grurë në Kinë duhet 6 orë punë dhe po kaq duhen edhe për  $\frac{3}{4}$  kg oriz). Pra kostoja oportune e grurit austalian është më e ultë se kostoja oportune e grurit kinez (sepse  $\frac{1}{2}$  është më e vogël se  $\frac{3}{4}$ ), prandaj themi që Australia ka një avantazh krahasues ndaj Kinës në prodhimin e grurit.


### *Kërkesa dhe oferta për importe dhe eksporte*

Pasi sqaruar domosdoshmerin e trgtisë midis vendeve të ndryshme, le të shikojmë mekanizmin që përcakton nivelin e tregtisë midis tyre. Për të thjeshtësuar analizën, supozojmë se kemi vetëm dy vende, për shembull Shqipërinë dhe Greqinë, edhe një produkt, për shembull mollë.

Fillimisht le të shikojmë se sa mollë do të dëshironte të impononte Shqipëria çdo vit. Këtë e përcaktojmë duke llogaritur kërkesën e tepërt për mollë në Shqipëri. Le t'i referohemi Figueës 24.1(a), e cila paraqet tregun e mollëve në Shqipëri për një vit të dhënë.

Në qoftë se çmimi botëror (në rastin tonë bota përbëhet vetëm nga Greqia dhe Shqipëria) është 5000 lekë toni, pra aq sa është çmimi i ekuilibrit në tregun shqiptar, është e qartë që Shqipëria nuk ka as kërkesë dhe as ofertë të tepërt për mollë, kështu që nuk ka nevojë të importojë, ose nuk ka mundësi të eksportojë. Në qoftë se çmimet botërore do të ishin më të ulët se 5000 lekë, atëher do të kishim një sasi të ofruar më të vogël dhe një sasi të kërkuar më të madhe, pra do të kishim një tepërcë kërkesë në tregun shqiptar.

Duke pasqyruar këtë tepërcë kërkesë, sipas niveleve përkatëse të çmimeve në një grafik, përfitojmë kurbën e kërkesës së tepërt (Figura 24.1(b)), e cila është njëkohësisht edhe kurba e kërkesës për importe.




Kjo kurbë shpreh bashkësinë e pikave që i përgjigjet nivelit të çmimeve në boshtin vertikal dhe kërkesës së tepërt (diferenca midis sasisë së kërkuar dhe sasisë së ofruar), në boshtin horizontal. Në rastin tonë, në nivelin 5000 lekë të çmimit kërkesa e tepërt është zero, prandaj kurba pret boshtin vertikal, kurse me çmimin 2000 lekë toni, kërkesa e tepërt është 300 ton (400-100), prandaj pika A i përket nivelit 300 në grafikë. Kurba e kërkesës së tepërt është njëkohësisht dhe kurba e importit për mollë në Shqipëri, sepse çdo kërkesë e tepërt përbën një mundësi potenciale për import për çdo nivel të dhënë të çmimit.

Tani le të shikojmë anën tjetër të medaljes. Sa mollë do të kishte mundësi të eksportonte Shqipëria. Kjo përcaktohet duke llogaritur ofertën e tepërt për mollë. I referohemi Figurës 24.2(a) që paraqet përsëri tregun e mollëve në Shqipëri.


Siç thamë, në çmimin 5000 lekë toni nuk ka as kërkesë të tepërt dhe as oferte të tepërt, pra nuk ka asnjë mundësi për eksport. Për çmimet botërore më të larta se 5000 kemi, siç del nga Figura 24.2(a), një oferte të tepërt. Duke arsyetuar njëloj si në rastin e kërkesës së tepërt përcaktojmë ofertën e tepërt dhe ndërtojmë kurbën e saj që është njëkohësisht edhe kurba e ofertës për eksportet.

Figura 24.2; Tregu i mollëve dhe oferta e tepërt në Shqipëri



3  
2  
D  
200 700 moll ton 500 moll ton

Figura 24.3; Tregu i mollëve në Greqi.




Duke e arsyetuar në të njëjtën mënyrë për Greqinë, mund të ndërtojmë kurbat përkatëse për importe dhe eskporte për mollë [Figura 24.3].


Ekulibri në tregun grek arrihet në çmimin 2000 dhrahmi për ton. Duke supozuar kursin e këmbimit 1 dhrahmi = 0,5 lekë, atëherë çmimi i ekulibrit do të ishte 1000 lekë për ton. Çmimet e ekulibrit të tregut në të dy vendet, përkatesisht 5000 lekë dhe 1000 lekë, quhen çmime të tregtisë zero.

Për të parë se si përcaktohet çmimi dhe sasia që tregohet midis dy vendeve i referohemi

Figurës 24.4.

Figura 24.4: Ekulibri në tregun ndërkombëtar të mallrave






Pika E ku pritet kërkesa e tepërt (për importe) e Shqipërisë me ofertën e tepërt (eksportet) të Greqisë, është pika e ekuilibrit, të cilës i përgjigjet çmimi 3000 lekë për ton. Sasia e importuar nga Shqipëria do të jetë 250 ton dhe po kaq do të jetë sasia e eksportuar nga Greqia.

Konkluzioni që mund të nxjerrim është se niveli i çmimeve dhe sasisë së importuar, varet nga forma konkrete e kurbave përkatëse, por, sidoçoftë ky çmim nuk mund të jetë as më i vogël se 1000 lekë/toni dhe as më i madh se 5000 lekë për ton.

Analizën e mësipërme e zhvilluam duke supozuar një treg të lirë ndërkombëtar, pra një treg plotësisht konkures. Në fakt, praktika vërteton se në kohë të ndryshme dhe vende të ndryshme shteti ndërhyr duke kufizuar tregtinë e lirë, duke ndjekur politika proteksioniste. Cilat janë argumentet që e mbrojnë proteksionizmin dhe kundërshtojnë tregtinë e lirë?

- **Mbrojtja e degëve "foshnjore".** Në qoftë se vende të ndryshme dëshirojnë të zhvillojnë një degë të caktuar dhe ajo nuk është që në fillim aq efiçente sa të përballojë konkurrencën e huaj, atëherë ky vend merr masa mbrojtëse, duke vendosur tarifa mbi importet, derisa kjo industri të bëhet efiçente dhe të konkurojë në tregun botëror. Ky argument qëndron, në një masë të caktuar, për periudha afatshkurtëra për të mbrojtur industrinë e reja deri në maturimin e tyre. Por me këtë argument mund të abuzohet duke zgjatur mbrojtjen tej maturimit me efekte negative në mirëqënien komunitare.
- **Kundërveprimi ndaj politikave të dumpingut dhe subvencioneve që ndjekin vendet e tjera.** Një argument i fortë për të kufizuar tregtinë e lirë është kundërveprimi ndaj politikës së subvencioneve për eksportet që mund të ndjekin vendet e tjera, e cila përbën një rrezik për prodhuesit e brendshëm. Për ti mbrojtur këta prodhues nga efektet e kësaj politike, vendosen masa kufizuese për importet, si tarifa doganore etj. Ndonjëherë vihet re edhe fenomeni i dumpingut, që shpreh shitjen e produkteve në një treg të huaj me çmime më të ulta se në tregje të tjera të huaja ose se në tregun e brendshëm. Ky fenomen mund të ndodhë edhe kur një vend dëshiron të eliminojë stoqet e mallrave të caktuara, por ai lidhet sidomos me synimet ekspansioniste për të zaptuar tregjet të caktuara. Pikërisht synimet ekspansioniste të dumpingut justifikojnë politikat kundërvepruese me anë të masave proteksioniste.

Dy janë rrugët kryesore për të realizuar kufizimin e tregtisë së lirë:



- **Kuotat**, përfaqësojnë një kufizim të vendosur nga shteti në sasinë e një malli të veçantë që importohet nga një vend tjetër në vendin përkatës. Kuotat përfaqësojnë një kufizim sasior i cili çon në rritje të çmimeve të mallrave të brendshme, duke stimuluar prodhimin e brendshëm, por njëkohësisht çojnë edhe në paksimin e eficiencës ekonomike.
- **Tarifat**, përfaqësojnë taksa të vendosura mbi mallrat e importit. Karakteri mbrojtës i tarifës qëndron në faktin që ajo vendoset vetëm për mallrat e importit. Pra prodhuesit e brendshëm nuk paguajnë taksë. Përkundrazi, ata tani rrisin të ardhurat sepse kanë mundësi të vendosin çmime më të larta, të njëjta me ato të importit.

## 11.2. Bilanci i pagesave, tregu valutor dhe kurset e këmbimit

Aktiviteti i brendshëm ekonomik matet nëpërmjet llogaritjes së GDP dhe komponentëve të tij, kurse aktiviteti ndërkombëtar që ka të bëjë si me këmbimin e mallrave, ashtu edhe me qarkullimin e kapitalit, matet nëpërmjet bilancit kombëtar të pagesave. Bilanci i pagesave është një koncept i përgjithshëm që shpreh totalin e gjithë transaksioneve të një vendi me vendet e tjera gjatë një viti. Bilanci i pagesave jep në mënyrë të përmbledhur informacion për eksportet dhe importet, të ardhurat e vendeve, për aktivet e vendosura jashtë, lëvizjet ndërkombëtare të kapitalit, të ardhurat e të huajve, për aktivet e blera brenda vendit, transaksionet zyrtare të Bankës Qendrore dhe shtetit, transferimet e njëanshme, etj.


Bilanci i pagesave përbëhet nga katër pjesë kryesore dhe në mënyrë të përmbledhur paraqitet në Tabelën 24.2. Le të shohim shkurtimisht pjesët përbërëse të bilancit të pagesave.

**I.Llogaria korente.** Në këtë llogari përfshihet lëvizja e mallrave, pra eksporti dhe importi i tyre. Diferenca midis eksportit dhe importit jep gjëndjen ose saldon e bilancit tregtar, që e kemi quajtur edhe eksport neto. Në llogaritë korente përfshihet edhe shitja e blerja e shërbimeve si dhënia e marrja me qera e mjeteve të transportit, shërbimet financiare për të huajt, transferimet e njëanshme, etj.

**II.Llogaria e kapitalit.** Këto llogari përfshijnë lëvizjet e ndryshme të kapitalit brenda, jashtë vendit dhe anasjelltas, në formën e huave private ose shtetërore. Lëvizjet e kapitalit bëhen nëpërmjet shitjeve dhe blerjeve të letrave me vlerë si aksione, obligacione, etj., të cilat qojnë në marrjen e valutës nga jashtë, ose në nxjerrjen e valutës jashtë.

Tabela 24.2: Bilanci i pagesave të Shqipërisë viti 1992 (të dhëna të supozuara)

Zërat e bilancit	Kredi	Debi	Tepricë
------------------	-------	------	---------



<b>I.</b>	<b>Llogaria korente:</b>			
1.	Veprime tregtare	3000	4500	-1500
2.	Veprime jo tregtare, transferta etj.	40	20	+20
3.	Bilanci i llogarive korente	-	-	-1480
<b>II.</b>	<b>Llogaritja e kapitalit:</b>			
4.	Lëvizja e kapitaleve (huadhënia është debi)	2000	600	+1400
5.	Bilanci I tregtisë së kapitalit	-		+1400
<b>III.</b>	<b>Mospërputhja statistikore:</b>			
6.	Shuma kompensuese	-	-	10
<b>IV.</b>	<b>Rezervat zyrtare:</b>			
7.	Gjendja e rezervave zyrtare	-	-	-70
8.	Gjendja e bilancit total	-	-	+70
<b>Totali:</b>				

**III.Mospërputhja statistikore.** Këtu përfshihet shuma neto e të gjitha transaksioneve të paregjistruara.

**IV.Rezervat zyrtare.** Kur shuma e tre zërave të mësipërme jep një diferencë negative, pra kur bilanci i pagesave është me deficit, atëherë shteti ndërhyr për të bërë pagesa për mbulimin e deficitit. Në kohën e standartit të arit bilancimi i bilancit të pagesave bëhet nëpërmjet eksportit dhe importit të arit, kurse sot bëhet nëpërmjet pagesave zyrtare.

### 11.3.Kurset e këmbimit dhe tregu valuator

Tregtia ndërkombëtare e të mirave realizohet nëpërmjet këmbimit të tyre me ndërmjetësin e parasë. Ndryshe nga këmbimi i brendshëm që realizohet me të njëjtën njësi monetare këmbimi i jashtëm realizohet me monedha të vendeve të ndryshme. Është e qartë se, në qoftë se, për shembull, eksportojmë mjaltë në Itali, blerësit (është fjala për firmat shqiptare që merren me eksportin) duhet të na paguajnë me lekë, dhe nga ana tjetër kur blejmë mallra, për shembull,



makarona, në Itali, duhet të paguajmë me lireta. Pra, lind domosdoshmëria e këmbimit të valutave të ndryshme për të realizuar këmbimin e mallrave. Kështu, italianët (firma shqiptare e eksportit) duhet të këmbajnë liretat me lekë për të paguar mjaltin që blejnë nga shqiptarët, kurse shqiptarët duhet të bëjnë të kundërtën për të paguar italianët për makaronat që blejnë nga ata. Valutat e ndryshme këmben në tregun valuator në bazë të kursit të këmbimit, i cili përfaqëson çmimin e një valute të shprehur në një valutë tjetër. Kursi i këmbimit mund të shprehet si çmim i valutës vendase në terma të valutës së huaj, për shembull, 1 lekë = 0.1 dollarë, ose si çmim i valutës së huaj në terma të valutës vendase, në rastin tonë 1 dollar = 100 lekë. Me të drejtë lind pyetja: *Pse kurset e këmbimit kanë një nivel të caktuar në një kohë të dhënë dhe pse ndryshon ky nivel? Cilët janë faktorët që i përcaktojnë ato?* Për të kuptuar përcaktimin e kurseve të këmbimit është e nevojshme të analizojmë si vepron tregu i këmbimit të valutave.

**Tregu valuator** përfaqëson një treg specifik, ku realizohet këmbimi i valutës vendase me valutat e huaja. Si në çdo treg tjetër, çmimi, pra kursi i këmbimit, përcaktohet nga kërkesa dhe oferta e valutave që këmben. Faktorët që përcaktojnë kërkesën dhe ofertën për valutë vendase në raport me valutat e huaja janë të shumtë. Më konkretisht, duke supozuar një shembull të thjeshtuar ku marrim parasysh vetëm tregtinë midis Shqipërisë dhe Greqisë, themi që kërkesa për lekë vjen nga njerëzit që kanë nevojë për to për të blerë mallra shqiptare, kurse oferta e lekëve vjen nga njerëzit që blenë mallra dhe shërbime në Greqi dhe për këtë qëllim duhet të këmbajnë lekët me dhrahmi greke. Pra, *kërkesa për lekë varet nga madhësia e eksporteve shqiptare ndërsa oferta për lekë varet nga madhësia e importeve shqiptare*, prandaj faktorët që përcaktojnë madhësinë e tyre përcaktojnë edhe kërkesën edhe ofertën për lekë.

**Kërkesa për lekë.** Duke shënuar kërkesën për lekë me  $D_l$ , mund të shkruajmë

Kërkesa për lekë lidhet negativisht me kursin e këmbimit të lekut sepse nëse leku do të zhvlerësohet (në formën që e kemi shprehur në si  $1/gdr$  ai do të ulej) atëherë mallrat shqiptare do të bëheshin më të lira për grekët, duke nxitur rritjen e importeve greke nga Shqipëria, si rrjedhim, dhe të kërkesës për lekë që duhen për të blerë këto mallra. Për një sqarim më të mirë, marrim një shembull. Supozojmë se Greqia importon mish qengji nga Shqipëria dhe se çmimi i tij është 400 lekë për kilogram. Po që se kursi i këmbimit të lekut është 1 lekë = 2,5 dhramin, atëherë çmimi për grekët do të jetë 400 lekë  $\times$  2,5 = 1000 dhram për kilogram. Në qoftë se leku zhvlerësohet në kursin 1 lekë = 2 dhrami, atëherë ky çmim do të jetë 400 lekë  $\times$  2 = 800 dhrami për kilogram. Si rrjedhim, grekët do të kërkojnë me shumë mish qengji shqiptar, duke rritur edhe kërkesën për lekë shqiptare.

Duke bërë supozimin e arsyeshëm që kemi bërë edhe për mallrat e tjerë, kërkesën për lekë e shikojmë vetën si funksion të kursit të këmbimit dhe të gjitha faktorët e tjerë i marrim të dhënë. Në keto kushte, kurba e kërkesës për lekë do të ishte një kurbë me pjerrësi zbritëse, siq është paraqitur në Figurën 24,5a, ku në boshtin horizontal kemi vendosur sasinë e lekëve dhe në boshtin vertikal kursin e këmbimit të lekut,  $1/gdr$ . Ashtu si në rastin e mallrave të tjerë,

ndryshimi i faktorëve që i kemi marrë të dhënë, e zhvendos kurbën e kërkesës për lekë poshtë ose lart në vartësi të ndikimit specifik të çdo faktori.


- Konkretisht, rritja e  $Y_G$  do të rriste importet nga Shqipëria, sepse, siç kemi theksuar më parë, rritja e të ardhurave greke rrit kërkesën për mallra nga grekët pra, edhe kërkesën për mallra importi nga Shqipëria në vartësi të prirjes marxhinale për importe. Rritja e importeve shqiptare do të rrisë kërkesën për lekë për çdo nivel të kursit të këmbimit, duke zhvendosur kurbën e kërkesës për lekë djathtas lart. Në qoftë se  $Y_G$  zvogëlohet do të kemi zhvendosje në drejtim të kundërt.
- Rritja e  $P_{SH}/P_G$  do të thotë që mallrat shqiptare bëhen më të shtrenjta për grekët dhe, si rrjedhim, importet greke do të zvogëlohen, duke zvogëluar kërkesën për lekë në çdo kurs këmbimi të dhënë, prandaj kurba e kërkesës për lekë zhvendoset majtas poshtë, dhe e kundërta për uljen e  $P_{SH}/P_G$ .
- Rritja e  $i_{sh}/i_g$  do të thotë që investimet financiare greke në Shqipëri të rriten, sepse bëhen më të leverdishme, duke rritur kërkesën për lekë në çdo kurs këmbimi, prandaj kurba e kërkesës për lekë do të zhvendoset djathtas lart, dhe e kundërta për uljen e  $i_{sh}/i_g$ .

**Oferta e lekëve.** Duke shënuar ofertën për lekë me  $S_L$  mund të shkruajmë.

$S_L = f(\text{Importe shqiptare} = \text{Eksporte greke}) = f(e_1, Y, P_{SH}/P_G, i_{sh}/i_g)$ , ku  $Y$  = produkti i brendëshëm bruto i Shqipërisë (ose të Ardhurat Kombëtare të Shqipërisë)

Oferta për lekë lidhet pozitivisht me kursin e këmbimit të lekut me drahmi sepse, në qoftë se leku do të rivlerësohet, atëherë mallrat greke do të bëhen më të lira, duke nxitur importet shqiptare nga Greqia dhe, si rrjedhim, edhe të ofertës së lekëve në këmbim me drahmitë që duhen për të blerë këto mallra. Për një sqarim më të mirë, marrim një shembull. Supozojmë se Shqipëria importon mish pule nga Greqia dhe se një kilogram mish pule në Greqi kushton 500 dhrami. Po qe se kursi i këmbimit të lekut tështë 1 lekë = 2 dhrami, atëherë qmimi i një kilogram mish pule në Shqipëri do të ishte 500 dhrami:  $2 = 250$  lekë për kilogram. Në qoftë se leku rivlerësohet, përshembull, në 1 lekë = 2.5 dhrami, atëherë mishi i pulës greke do të bëhet më i lirë për shqiptarët, në rastin tonë, 500 dhrami:  $2.5 = 200$  lekë. Si rrjedhim, shqiptarët do të kërkojnë më shumë mish pule greke, duke rritur importin nga Greqia. Duke supozuar, si në rastin e kërkesës, të gjithë faktorët e tjerë të dhënë (përveq kursit të këmbimit të lekut me dhramin), atëherë kurba e ofertes për lekë do të ishte një kurbë me pjerrësi rritëse, siq është paraqitur në figurën 24.5a, ku në boshtin horizontal jepet oferta e lekëve dhe në boshtin vertikal jepet kursi i këmbimit të lekut me dhramin. Ndryshimi i faktorëve që i kemi marrë të dhëna e zhvendos kurben e ofertes për lekun poshtë me ose lartë, në vartësi të ndikimit specifik të çdo faktori.

- Rritja  $Y$  rrit kërkesën e shqiptarëve për mallrat dhe, si rrjedhim, edhe për mallra greke në vartësi të prirjes marginale për importe. Rritja e importeve nga



Greqia do të rrisë ofertën e lekut në qdo kurs të dhënë këmbimi të lekut me dhramin, duke e zhvendosur kurben e ofertes për lekë djathtas – poshtë. Po qe se zvoglohet  $Y$ , atëherë kurba e ofertes e do të zhvendosej majtas lartë.

- Rritja e  $P_{SH}/P_G$  do të thotë që qmimet e mallrave shqiptare bëhen më të shtrenjtë në krahasim me ato të mallrave greke, duke nxitur importin e tyre nga Greqia. Si rrjedhim, oferta e lekëve në këmbim më dhrahmitë që nevojiten për të blerë këto mallra greke, për qdo kurs të dhënë të këmbimit të lekut me dhrahminë, do të rritet, prandaj kurba e ofertes e lekëve do të zhvendoset majtas poshtë. Po qe se  $P_{SH}/P_G$  zvoglohet, atëherë kurba e ofertes do të zhvendosej djathtas lartë.
- Ulja  $I_{sh}/I_g$  do të thotë që investimet financiare në Greqi bëhen më të levërditshme, duke nxitur daljen e kapitaleve jashtë, pra në çdo kurs të dhënë të këmbimit të lekut, rritet oferta e lekëve në këmbim me dhramin, për të blerë letra me vlerë në Greqi. Prandaj, kurba e ofertës e lekëve zhvendoset majtas – poshtë. E kundërta ndodhë  $I_{sh}/I_g$  rritet : kurba e ofertës zhvendoset djathtas – lartë.  
Ekuilibri në tregun valutor vendoset në pikëprerje e kurbës së kërkesës për lekët me kurbën e ofertes së lekëve. Këtij ekuilibri në figurën 24.5 (a) I përgjigjet nivelit  $e_0$  I kursit të këmbimit dhe  $l_0$  i sasisë së treguar të lekëve. Figura 24.5 : Tregu valutor  
Ndryshimet në faktorët e tjerë qojnë, siç theksuam më lartë, në zhvendosjen të kurbave të kërkeses dhe të ofertes, duke vendosur një ekuilibër të ri. Për shembull, po qe se të ardhurat e grekëve rriten, pra rritet  $Y_G$  atëherë, siq treguam më lart kurba e kërkesës për lekë do të zhvendosej djathtas lart, duke qar në një ekuilibër të ri  $E_1$ , siq tregohet në figurën 24.5(b). Këtij ekuilibri i përgjigjet një kurs më i lart këmbimi,  $e_1$ , dhe një sasi më e madhe e lekëve të këmbyerë  $l_1$ .

### Llojet e kurseve të këmbimit

*Kurse këmbimi fikse.* Sistemi i kurseve fikse të këmbimit ka qen mbizotërus deri ne vitin 1973, kur u prish marrëveshja e Bretton Woods-it. Këto kurse përcaktohen zyrtarisht nga shteti dhe janë relativisht të pandryshueshme. Niveli i tyre ruhet nëpërmjet ndërhyrjes së Bankës Qëndrore, e cila shet ose blen valuta të huaja, sipas nevojave të tregut valutor. Për shembull po që se në treg ka tepric kërkesë për lekë, pra ka presion për të rivlersuar lekun, atëherë Banka Qëndrore ndërhyr duke shitur lekë dhe duke blerë valuta të huaja, pra ajo ploteson nevojat për lekët dhe rrit rezervat e saj në valutë të huaj. Ndryshimi i kurseve fikse bëhet zyrtarisht dhe , në këtë rastë thuhet se kemi të bëjme me rivlëresim kur rritet kursi i këmbimit dhe më zhverësim kur bie kursi i këmbimit. Për shembull, në qoftë se supozojmë qe kursi i këmbimit të lekutë me dhrahminë, është 1 lekë = 2 dhrahmi, themi që leku është rivlersuar në qoftë se kursi bëhet 1 lekë = 2.5 dhrahmi, dhe e kundërta themi që leku zhvlëresohet kur kursi i këmbimit bie.

Kurset luhatëse të këmbimit përqaktohen drejtpërdrejt nga forcat e tregut. Ato ndryshojnë sa herë që ndryshojnë edhe faktorët që përcaktojnë kërkesen dhe ofertën e

lekëve në treg. Shteti mund të ndërhyjë në tregun valuator për të ndikuar në kurset valutore, kur ato dalin përtej kufinjëve të dëshirueshëm. Në këtë rast kemi të bëjmë me kurse këmbimi të menaxhuara, të cilat aktualisht përbëjnë një politikë të zakonshme valuator të qeverisë të shumë vendeve. Në Shqipëri, që nga viti 1992 kanë filluar të përdoren kurse këmbimi luhatëse të menaxhuara. Në rastin e kurseve fleksibile themi që kemi mbiçmim të kursit të këmbimit. Kur këto kurse rriten, dhe nënçmim të tyre, kur këto kurse ulen.

